

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE



Botim special i Institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë
Tetor 2018

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka mundësuar hartimin e këtij materiali për zhvillimin rural të 13 fshatrave turistike të Qarkut Gjirokastrë të përfshira në Programin e Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) i cili synon të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirat rurale.

PËRMBAJTJA

I. Programi “100 Fshatrat”	1
II. Qarku Gjirokaštër	3
A. Ndarja administrativo-territoriale	3
B. Të dhëna të përgjithshme	3
C. Fshatrat e përzgjedhur	5
1. Bashkia Gjirokaštër	6
1.1 <i>Fshati Dhoksat</i>	6
1.2 <i>Fshati Zhulat</i>	15
1.3 <i>Njësia Administrative Antigone</i>	22
1.4 <i>Fshati Lazarat</i>	31
2. Bashkia Libohovë	41
2.1 <i>Fshati Labovë e Sipërme</i>	41
2.2 <i>Fshati Nepravishtë</i>	46
3. Bashkia Tepelenë	55
3.1 <i>Fshati Nivicë</i>	55
3.2 <i>Fshati Peshtan</i>	64
4. Bashkia Memaliaj	70
4.1 <i>Fshati Kalivaç</i>	70
5. Bashkia Përmet	75
5.1 <i>Fshati Leusë</i>	75
5.2 <i>Fshati Kosinë</i>	79
6. Bashkia Këlcyrë	83
6.1 <i>Fshati Malëshovë</i>	83
7. Bashkia Dropull	88
7.1 <i>Fshati Sotirë</i>	88

PARATHËNIE



*P*rogrami Kombëtar për Zhvillimin Rural “100 Fshatrat” me objekt kryesor hartimin e modeleve të zhvillimit për secilin prej tyre, bazuar tek potenciali turistik dhe i iniciuar nga Qeveria Shqiptare bën pjesë në gjerdanin e reformave jetëdhënëse e frymëzuese që po marrin jetë hap pas hapi në mandatin e dytë të saj. Ky program transformues nis rrugën me 100 lulet e para në buqetën prej 2962 të fshatrave shqiptarë. Pas rivitalizimit të gjithë qyteteve, rivitalizimi i fshatrave e jetës së tyre është sfida e re e guximshme e jona e përbashkët. Ky program që të entusiazmon me synimet që shpalos, shpërfaqen vizionet, objektivat e rezultatet që do të arrihen me përmirësimet infrastrukturore mjedisore turistike, të monumenteve natyrore e kulturore, gjer sot në letargji, me ringjalljen e turizmit e agroturizmit dhe përmirësimin e shërbimeve tregtare me produktet tradicionale aq shumë të kërkuara nga të gjithë.

Në një vështrim panoramik, peisazhet rurale gërshetojnë vlera pa fund, vlera kulturore të papërsëritshme por edhe mundësi reale sociale, që kërkonin vizionet e që tashmë po u afrohen me përkushtim e me vendosmëri nga tërë aktorët e faktorët e Shqipërisë që po rilind e transformohet. Kush gëzon kaq resurse të bollshme se sa fshati shqiptar?! Është i bekuar, i lakmuar por i harruar.

Përvojat, arritjet e djeshme, me këtë program ambicioz do të shënojnë më shumë rritje, maja të pabesuara mirëqënieje për mjedisin jetik rural e më gjerë, të krijuara me duart e mendjet e tyre por pa dyshim me shtysën e inkurajimin e Qeverisë Shqiptare. Në qarkun tonë, 13 fshatrat do të jenë dallëndyshet e para mes 287 fshatrave që përfshin ndarja administrative e territoriale me një pikësynim të qartë e tej pamës. Në këtë nismë, tashmë të prekshme do të aktivizohen të gjitha energjitë produktive të banorëve, projektet e koordinuara të të gjithë agjencive përgjegjëse pas studimeve krahasuese e sigurimit të rrugëve e mjeteve në favor të projekteve. Mjedi rural në fokus ofron e do të ofrojë gjithë potencialet e trashëguara të efektshme por gjer sot të fjetura e të pangacmuara nga askush. Do të duhej bashkimi i energjive njerëzore me aleatin e përhershëm mjedis vlerash, që rrezaton me vendosmërinë e qeverisë shqiptare në shërbim të qytetarëve të tij cep me cep të “Shqipërisë që duam”. Programi “100 fshatrat” nuk është një program që kufizon zhvillimin rural vetëm në 100 fshatra por është një model zhvillimi rural i bazuar tek investimet

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

në agroturizëm dhe ekoturizëm duke shfrytëzuar trashëgiminë kulturore, natyrën tonë të mrekullueshme, traditën dhe resurset lokale.

Procesi ka nisur, ka marrë rrugën e mbarë, si çdo reformë frytdhënëse gjer më sot dhe do të vazhdoj pa u ndalur. Mbështetja e administratës dhe institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë do të jetë vazhdimisht pranë, për ti dhënë jetë këtij programi.

Le të jemi gjithmonë pranë njëri tjetrit në realizimin edhe të këtij projekti frymëzues e të pandalshëm që do të na bashkojë forcat me projekte të tjera të vazhdueshme.

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë
ASTRIT ALIAJ

I. Programi “100 Fshatrat”

Qëllimi i Programit

Programi i Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR) – Programi i 100 fshatrave synon të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, përcaktuar në shtojcën B të kësaj strategjie, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë, duke u shkëputur nga ndërhyrjet e copëzuara dhe me qasje strikte sektoriale, që po ndodhin apo pritet të ndodhin në vend.

Objektivat e Programit

PIZHR do të programojë ndërhyrjet me investime të integruara në zonat e përcaktuara (100 fshatra), nëpërmjet 3 objektivave si më poshtë:

- a) Përmirësimi i infrastrukturës publike (mbështetja për infrastrukturë rrugore, rivitalizime hapësirash publike/urbane, infrastrukturë komunitare, shërbime publike, infrastruktura mjedisore, turistike, monumente të trashëgimisë kulturore, qendra multifunkionale komunitare, pejsazhi mjedisor).
- b) Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike (përmirësimi i potencialit turistik në hapësirat rurale, agroturizëm dhe turizëm rural, investimet në përmirësimin e shërbimeve tregtare, investime në prodhimin e produkteve tradicionale dhe shërbime të tjera ekonomiko-financiare etj. Mbështetja për inkubatorë të produkteve rurale tradicionale, promovim dhe marketim të zonave rurale, shërbime transporti, panaire dhe festat lokale).
- c) Zhvillim i kapitalit social dhe njerëzor (mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit si dhe shoqërinë civile në zonat rurale, trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë, mbështetje të trashëgimisë kulturore, mbështetje për promovimin e traditave dhe jetesës në fshat).

Kohëzgjatja e programit

“Programi i Integruar për Zhvillimin Rural–Programi i 100 fshatrave”, do të zbatohet në periudhën 2018-2020.

Zbatimi

Projektet e financuara në kuadrin e programit të 100 fshatrave do të zbatohen kryesisht nga bashkitë si dhe agjenci të tjera publike (Agjencitë e Zhvillimit Rajonal 1,2,3 dhe 4, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, Agjencia Kombëtare e Turizmit, FSHZH, MADA, etj.).

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Programi do të mbështesë edhe projekte të propozuara nga organizatat e shoqërisë civile (OJF), individë, fermerë, persona juridik etj., në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Projektet Strategjike

Në kuadrin e programit të 100 fshatrave, janë identifikuar 3 projekte strategjike të cilat do të zbatohen me prioritet të lartë:

i) Krijimi i rrjetit të agroturizmit shqiptar

Programi do të synojë mbështetjen për rreth 27 sipërmarrje agroturizmi të reja dhe 150 bujtina. Mbështetja do të synojë gjithashtu edhe përmirësimin e fermave dhe staneve blegtorale për qëllime të veprimtarisë së agroturizmit dhe turizmit rural.

i) Rrjeti i inkubatorëve të produkteve tradicionale

Programi do të synojë të krijojë rrjetin e “Inkubatorëve të Produkteve Tradicionale”, që do të jenë hapësira që ofrojnë infrastrukturë të gatshme për të gjithë zinxhirin e vlerës së produktit, duke filluar që nga ambjentet dhe pajisjet e prodhimit/magazinimit, linjave të paketimit dhe marketimit, mbështetje për standartizimin dhe çertifikimin, si dhe hapësirë për shitje të produkteve.

iii) Rrjeti i markatave/dyqaneve të produkteve shqiptare dhe tradicionale

Produktet tradicionale shqiptare kanë treguar që e kanë të vështirë depërtimin në tregjet dhe dyqanet e shitjes me pakicë, për shkaqet e shpjeguara në nën-pikën ii). Në mbështetje të “hallkës” së fundit të zinxhrit të vlerës (shitja), programi do të synojë që të krijojë një rrjet të markatave/dyqaneve që do të jenë të specializuara në shitjen e produkteve shqiptare, në veçanti produkteve tradicionale. Do të synohet që ky rrjet të ketë emërtimin e vet (markën/brandin) që e dallon nga rrjetet e tjera dhe bazuar në një strategji të posaçme marketingu dhe franchise, do të mund të krijojë një masë kritike të dyqaneve që do të bëjnë të mundur rritjen e përqindjes së shitjes së produkteve shqiptare/tradicionale. Mbështetja financiare për ngritjen e këtij rrjeti do të parashikohet në kuadrin e programit të “100 fshatrave.”

II. QARKU GJIROKASTËR

A. Ndarja administrativo-territoriale

Nr.	Bashkia	Qendra e bashkisë	Qytet	Njësi Administrative	Fshatra
1	Bashkia Gjirokastrë	Qyteti Gjirokastrë	1	7	38
2	Bashkia Libohovë	Qyteti Libohovë	1	3	17
3	Bashkia Dropull	Fshati Jorgucat		3	41
4	Bashkia Tepelenë	Qyteti Tepelenë	1	4	41
5	Bashkia Memaliaj	Qyteti Memaliaj	1	6	53
6	Bashkia Përmet	Qyteti Përmet	1	5	49
7	Bashkia Këlcyrë	Qyteti Këlcyrë	1	4	48
Totali			6	32	287

(Bazuar në ligjin nr. 115/2015 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në republikën e Shqipërisë”)

B. Të dhëna të përgjithshme

Qarku i Gjirokastrës është një nga 12 qarqet në Republikën e Shqipërisë me një sipërfaqe prej 2884 km².

Si qark është i pozicionuar në qendër të Shqipërisë Jugore dhe përshkohet nga dy prej luginave më të rëndësishme të Shqipërinë Jugore, Lugina e Vjosës së Sipërme dhe Lugina e lumit Drino, pozitë kjo e përshtatshme për zhvillimin ekonomik, me klimë mesdhetare, tokë prodhuese dhe bimësi të zhvilluar.

Rajoni përbëhet nga zona paramalore mesdhetare jugore Qarishtë – Dangëlli – Çarshovë, zona mesdhetare malore jugore Dhëmbel – Nemërçkë, Lunxhëri – Bureto dhe Mali i Gjerë – Stugarë. Baza e ekonomisë është bujqësia dhe blegtoria por në rajon po rritet dhe industria e përpunimit të ushqimit, duke shfrytëzuar mundësitë që jep prodhimi i frutave, primeve dhe nënprodukteve blegtorale.

Zhvillimi i turizmit për qarkun e Gjirokastrës, duke u bazuar dhe në trashëgiminë unike kulturore, historike dhe arkitekturore, është një nga rrugët

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

më efikase për ringritjen ekonomike dhe si rrjedhojë reduktimin e varfërisë në zonat rurale dhe urbane. Zhvillimin e turizmit e bëjnë të mundur burimet e shumta që ofron kjo zonë duke përmbyshur të gjitha kriteret për zhvillimin e të gjitha formave specifike të tij si:

- *Zhvillimi i turizmit kulturor*
- *Zhvillimi i turizmit të gjelbër*
- *Zhvillimi i eko-turizmit*

Potenciali i madh turistik i qarkut shprehet përveç të tjerash edhe në ekzistencën e 106 monumenteve natyrore nga të cilat:

- 4200 ha gëzojnë statusin si Park Kombëtar
- 7060 ha gëzojnë statusin si rezervat shkencor
- 13500 ha janë zonë peisazhore e mbrojtur

Vlen të përmendet ekzistenca e një sërë monumentesh natyrorë që natyra ia ka falur qarkut të Gjirokastrës si:

- Peisazhi turistik i Ujit të Ftohtë në Tepelenë
- Peisazhi turistik i liqenit artificial të Viroit në Gjirokastrë
- Parku natyror kombëtar i Hotovës në Përmet
- Pylli me bredha i Sotirës dhe peisazhi turistik i këtij fshati
- Fusha e Çajupit, Llufa e Nivicës në Kurvelesh
- Ujrat termale të Bënjës në rrethin e Përmetit

Pasuritë e këtij qarku janë të shumta dhe jo më kot në Programin e Integruar për Zhvillimin Rural – Programi i “100 fshatrave”, janë përzgjedhur 13 fshatra të qarkut Gjirokastrë, me potencial të lartë të zhvillimit ekonomiko-social, të trashëgimisë kulturore, agroturizmit, turizmit rural dhe mjedisit.

C. Fshatrat e përzgjedhur



Figura 1 Fshatrat e përzgjedhur në qarkun Gjirokastrë

Në shtatë bashkitë që përbëjnë qarkun Gjirokastrë janë përzgjedhur gjithsej 13 fshatra si më poshtë:

Bashkia Gjirokastrë

- 1. Fshati Dhoksat*
- 2. Fshati Zhulat*
- 3. Nj. Ad. Antigone*
- 4. Fshati Lazarat*

Bashkia Tepelenë

- 1. Fshati Nivicë*
- 2. Fshati Peshtan*

Bashkia Përmet

- 1. Fshati Leusë*
- 2. Fshati Kosinë*

Bashkia Libohovë

- 1. Fshati Labovë e Sipërme*
- 2. Fshati Nepravishtë*

Bashkia Memaliaj

- 1. Fshati Kalivaç*

Bashkia Këlcyrë

- 1. Fshati Malëshovë*

Bashkia Dropull

- 1. Fshati Sotir*

1. BASHKIA GJIROKASTËR

1.1 Fshati Dhoksat

1.2 Fshati Zhulat

1.3 Njësia Administrative Antigone

1.4 Fshati Lazarat

1.1 Fshati Dhoksat

Njësia Administrative Lunxhëri

Vendndodhja

Fshati Dhoksat bën pjesë në krahinën e Lunxhërisë, ish-komunë në qarkun e Gjirokastrës, ku me qytetin e Gjirokastrës e lidh një rrugë automobilistike me gjatësi rreth 10 km.



Figura 2 Fshati Dhoksat, pamje nga sateliti

Historia

Sipas Faik Konicës, Dhoksati është fjalë e greqishtes së vjetër që do të thotë “modeli i bukurisë strukture të një qendre të banuar”. Nuk mund të gjesh në asnjë vend një strukturë urbanistike fshati, të lashtë, të vjetër, të ri, të kohës së



sotme që të ketë strukturë urbanistike të këfillë. Shtëpitë e ngritura në strehë të njëra tjetrës duke ia përshtatur terrenit, me porta të larta, me hajate, me furrë pjekje, rrugët (sokakët) shtruar me kalldrëm etj. Është një fshat i hershëm i cili daton afër vitit 1431.

Figura 3 Shtëpi karakteristike me gurë

Duke qënë se Dhoksati ka këtë lloj urbanistike, me tre lagje (mëhalla), kemi të drejtën të mendojmë se rrënojat arkeologjike të pa eksploruara deri më sot, sikundër janë ato në Kala të Shëntriadhës, në Gjon – Bare,

Katundishte, Nik – Gjinë, Gërmadha, Shënkoll dhe tek kthesa e rrugës për në Dhimineza por edhe Mullinjtë e vjetër duhet të kenë qënë vendbanimet e para të Dhoksatit.

Gjeografia



Fshati Dhoksat bën pjesë në zonën klimaterike tranzitore, me gjerësi gjeografike lindore 20°, gjerësi gjeografike veriore 40°, ndërsa lartësia mbi nivelin e detit varion 300 - 500 m.

Figura 4 Pamje e fshatit Dhoksat, shkëmbi i Olrës

Presioni atmosferik mesatar vjetor është 744.1 m/m me temperaturë mesatare vjetore 16⁰ C, ndërsa mesatarja maksimale 21⁰ C. Gjatë muajit korrik arrin temperaturën në 35⁰ C ndërsa mesatarja minimale 10⁰ C.

Lagështira mesatare relative e ajrit arrin 71% ku gjatë vitit bien mesatarisht 2000 - 2530 m/m rreshje atmosferike.

Ka 160 ditë me shi ku maksimalisht vetëm 13 ditë në vit bie borë dhe vetëm 9 ditë në vit bie breshër, 20 - 30 ditë janë mesatarisht me mjergull, 112 me qiell të kthjellët ndërsa me re puplore 141 ditë.

Kufijtë

Fshati Dhoksat kufizohet nga lindja me krahinën e Zagories. Vija kufitare kalon gjatë ujëndarësit të malit të Lunxhërisë. Nga veriu kufizohet nga fshati Këllëz dhe tokat e tij.

Nga perëndimi fillon në mbarimin e rrugës Gjirokastër - Çajup dhe vazhdon drejt jugut, në pjerrësitë perëndimore të kodrave të Petrovcit dhe kalasë së Shën Triadhës.

Nga jugu fillon me pjerrësitë perëndimore të Kalasë, vazhdon drejt lindjes duke kaluar Kalanë, Shkëmbin e Pokajve, Rrapi i Dudit, kthehet drejt veriut deri në kreun e Bregut të Trashë ku kthehet drejt lindjes, vazhdon rrjedhën e përroit të Valtanadhit, në kreun e Hijes së Mallkuar, zbret në lumin Nimicë gjatë arrave të Mullirit të Vjetër, gjatë ujëndarësit të Kories së Madhe, Qafa e Korijes së Madhe, Mani i kuq në jug të Gjon Bareve, gjatë shpatit perëndimor të Sheshit të Dervishit, Shpella e Dudit, vazhdon vertikalisht gjatë shpatit të Malit të Lunxhërisë, deri në ujëndarësin ku takohet me Zagorien. Vija jugore që u përshkrua është edhe vija kufitare me fshatin Qestorat.

Popullsia

Popullsia e fshatit Dhoksat në kronikat dhe regjistrat osmane dhe më herët se viti 1431 përbëhet nga tre grupe etnike, autoktone lunxhote orthodoksë, vlllehë orthodoksë dhe labë të besimit musliman bektashi.

Në vitin 1922, ka pasur 262 banorë, në vitin 1990, ka pasur 615 banorë ndërsa sot numërohen vetëm 147 banorë.

Sipas një studimi në fund të viteve 80 të shekullit të 20 në Dhoksat kishte 37 familje lunxhote autokone, 23 familje vllahë dhe 13 familje labe. E thënë ndryshe 50 familje shqiptare, 13 vlllehë dhe një greke, gjithësej 64 familje, prej tyre 80% shqiptare etnike.

Arsimi dhe Shëndetësia

Deri në fund të viteve 1990-2000 kishte shkollë të arsimit fillor dhe tetë vjeçar. Më vonë me largimin e popullsisë si pasojë e emigracionit, ky institucion u mbyll dhe vazhdoi arsimimi në shkollat e qytetit të Gjirokastrës dhe sot e kësaj dite. Deri në vitet 90 ka patur edhe arsim të mesëm. Në këtë fshat kryhet shërbim ambulator nëpërmjet specialistit infermier.

Ekonomia

Kjo zonë është e orientuar ekonomikisht në vreshtari, bujqësi, blegtori, turizëm familjar dhe bletari.

Bujqësia: Dhoksati ka tokë dhe kushte për kultivimin e të gjithë llojeve të perimeve e zarzavateve. Bujqësia kryesisht ka qënë e orientuar drejt prodhimit të drithërave të bukës si grurë, misër. Gjithashtu ka qënë e zhvilluar pemtaria dhe vreshtaria. Kryesisht në këtë zonë mbillen pemë si molla, arra, dardha, bajamja dhe fiku.



Figura 5 Sheshi Lord Bajron, rrapi shekullor

Lëmenjtë: ka këtë emërtim, pasi në atë vend ishin disa lëmenj ku të zotët shisnin grurin. Lëmi i Haxhianaj, Çobaj, Maraj, Kostaj, Nerenxaj. Pozicioni gjeografik i këtij vendi ishte i favorshëm për të pastruar grurin nga byku, duke shfrytëzuar erën që frynte nga veriu.

Sadet: Një sipërfaqe e pjerrët me tokë zallishte aty këtu me shkurre, qelbes, cermedel, xane.

Lagajjt: Toka të pjerrëta. Mbilleshin me të lashta, duhan dhe perime. Ndodhen poshtë lëmit të Lekajt dhe shtëpisë së Goxharejve.

Dhionisët: Janë ara të punueshme. Punoheshin e mbilleshin nga Foto Qapja.

Blanjat: Sipërfaqe toke të punueshme, mbillen me misër dhe perime, janë nën ujë (ujiten).

Sini: Sipërfaqe toka arre nën ujë dhe mbilleshin kryesisht me misër por edhe me grurë.

Është një fshat i pyllëzuar dhe nqs do të lëvizim drejt shpellës së Matos do të kemi një livadh prej disa dynimesh ku mbizotërojnë druri i Goricës. Gjithashtu ka shkurre si qelbësi, xane, cermedel, dru frutor kryesisht bajame dhe disa livadhe me lisa.



Figura 6 Pamje e fshatit Dhoksat

Kullotat: Ka shtrirje kullotash të mirëfillta në qafën e Volastadhit, gjatë përroit tek Kalaja e Qesoratit dhe përfundon tek fusha e Dhoksatit. Bllanjat janë sipërfaqe toke të punueshme. Gjithashtu janë arrat e Polajve, Kacajve, arrat e mullirit, etj.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Blegtoria: Zona e Lunxhërisë dhe kryesisht fshati Dhoksat, është e prirë ndaj rritjes së bagëtive si dele, dhi dhe lopë. Afërsisht ka mbi 2000 kokë bagëti prodhimet blektorale të cilave përpunohen në punishten e qumështit në fshatin Shën Todër.

Rrjeti rrugor

Përsa i përket infrastrukturës rrugore, kjo zonë përshkohet nga rrugë automobilistike dhe rrugë këmbësore, konkretisht:

- Dhoksat - Qestorat vazhdon në gjithë Lunxhërinë e Sipërme
- Dhoksat - Këllëz, në Lunxhërinë e Poshtme
- Dhoksat - Gjirokastër
- Rruga e malit (rrugë për këmbësorët)
- Rruga automobilistike: e ndërtuar në vitet e sistemit socialist. Fillon në qendër të fshatit, vazhdon nëpër Kollovoz, kalon në lumin e Nimicës mbi një urë betoni. Në vendin e quajtur Shën Todhër kryqëzohet me rrugën automobilistike Gjirokastër – Çajup.



Figura 6 Rrugët e fshatit Dhoksat

- Rruga automobilistike Dhoksat – Këllëz dhe Dhoksat – Qestorat.
- Ka dhe rrugë të dyta në gjithë territorin, rrugë të dyta këmbësore : Rruga që fillon tek Kroi i poshtëm në Gurrëza, rruga që fillon tek Kroi i Poshtëm gjatë kopshtijeve të Varjanjëve, rruga në Shën Mëri, rruga e Blanjave, rruga gjatë fushës së Dhoksatit dhe rrugë të treta.

Rrjeti ujqor

Zona e Lunxhërisë ka një rrjet ujor të pasur si:

- Mëhalla e Sipërme (Kroi i Cajkës)
- Mëhalla e Mesit: Burimet i kanë kthyer në kroje. Krua me dy nivele dhe katër kupa guri të gdhendur.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

- Mëhalla e Poshtme (ka kroyin e vet me dy korita guri, govatë prej pllakash guri, mbulesë me qemer guri dhe çati me pllaka guri).
- Kroi i Peshajve (shfrytëzohej kryesisht nga fisi i Peshajve dhe përdorej për ujitjen e perimeve)
- Kroi i Peço Kokolit (daton përpara vitit 1900)
- Kroi i Theodhosit (ndodhet aty ku fillon Udhë e Bardhë, daton përpara viteve 1900)
- Kroi i Qendros (është funksional edhe momentalisht, i ndërtuar rreth 1925)
- Kroi i Gërmadhavë (në funksion të bujqësisë)
- Burimi i Shpellës së Dudit (tepër i nevojshëm si për njerëzit edhe për bagëtitë)
- Gurra e Dhoksatit (në këto 100 vitet e fundit është pakësuar ndjeshëm si prurje)
- Burimi i Shtegut të Miles
- Burimi i Shkëmbit të Orles (këtu e ka zanafillën Grabovica)
- Burimi i Përroit të Thëllëzave (ka shumë pak prurje, në verë shteron plotësisht)
- Burimi i Gjon Barës (është afër tokave të Gjon Bares dhe ka ujë dimër dhe verë)
- Burimi i Lagjave (ka shërbyer për të plotësuar nevojat e 4-5 shtëpive)
- Burimi Lisat e Sikos (ndodhet në fund të kories me lisa dhe derdhet në Përroitin e Vajsit)
- Burimi i Gaqes (fillon aty ku mbarojnë kodrat e Shën Thanasit, në krye të Bostanit të Gaqes)
- Burimi i Ajazmes (nuk është as burim, as krrua por gurgullon nga nëntoka dhe ka prurje të pakta)

Liqene (Ujëmbledhësa)

Ekzistojnë dy ujëmbledhësa të cilat përdoren për nevojat e banorëve në bujqësi.

Ujëmbledhësi i Dhoksatit: I ndërtuar nga ish-ndërmarrja e bonifikimit Gjirokastër për ujitjen e tokave bujqësore të krahinës së Lunxhërisë. Sot ky ujëmbledhës është në administrim dhe në shfrytëzim të bashkisë Gjirokastër me kapacitet të plotë 1.550.000 m³ ujë.

Bendi i Blanjave: Një ujëmbledhës i madh ku si digë shërbente një mur guri rreth 2 m gjerësi, 3-4 m lartësi dhe mbi 10 m i gjatë. Uji i mbledhur në të shërbente për të ujitur Fushën e Dhoksatit.



Uji i pijshëm

Uji i pijshëm në familjet e zonës së Dhoksatit sigurohet nga disa kroje të vjetra.

Figura 8 Ujëmbledhësi i Dhoksatit

Ka tre kroje natyral me rrjedhje të lirë, një ujësjellës nga mali me depozitë, Shtegu i Miles ku rrjedh një burim që e kanë futur në linjën e ujit të pijshëm për Dhoksatin dhe Gurra e Dhoksatit që rrjedh nën zall dhe derdhet në Grabovicë, burim i futur në rrjetin e ujit të pijshëm.

Lumenjtë

Lumenjtë që përshkojnë këtë zonë janë:

Nimica: Buron në jug të fshatit Qestorat. Në vendin e quajtur Arat e Mullirit bashkohet me Përroin e Klabet (Qestoratit) dhe hyn në tokat e Dhoksatit. Vazhdon rrjedhën e vet në perëndim të Dhoksatit dhe në vendin e quajtur Gërmadha (fundi i tyre) bashkohet me Grabovicën. Të dy bashkë formojnë lumin e Nimicës, degë e lumit Drino. Nimica hyn në territorin e Dhoksatit dhe deri sa bashkohet me lumin Drino por brenda territorit të Dhoksatit nuk ka përmytje. Në stinën e verës pothuajse shteron. Ujë të pakët përdoret për ujë.

Grabovica: Rrjedh në fundin e shkëmbit të Orles. Vazhdon rrjedhën lindje-perëndim. Në fund të Gërmadhave bashkohet me lumin Nimicë dhe e humb identitetin. Nuk ka burim të mirëfilltë. Prurjet e tij varen nga intensiteti i rreshjeve. Gjatë gjithë rrjedhës kalon në një shtrat të pjerrët dhe shkëmbor. Është i rrëmbyeshëm dhe sjell shumë inerte dhe gurë me vëllim deri në 1 m³.

Përrenjtë

Tokat e Lunxhërisë përshkohen nga rreth 12 përrenj të përkohshëm dhe të përhershëm si:

- Përroi i Vajsit: buron në jug të Gjon Bareve
- Përroi i Korijes së Madhe: buron në afërsi të qafës së kësaj koriye
- Përroi i Baltëzave: është i vogël dhe ushqehet më tepër nga shirat
- Përroi i Thëllëzave: buron tek vendi i quajtur Gorrica e Froso Haxhies
- Përroi i Thatë: buron tek Lisat e Kishës, vazhdon rrjedhën në anën jugore të Dhoksatit.
- Përroi i Ajazmës: fillon rrjedhën tek Ajazma e Shën Mërisë.
- Përroi i Cajkes: fillon rrjedhën te fundi i Arave të Bendit të Gurrës.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

- Përroi i Cjapit: Quhet me këtë emërtim aty ku bashkohet Përroi i Cajkes me ujët e Kroit të Poshtëm dhe merr emërtimin Përroi i Cjapit.
- Përroi i Valtanadhit: fillon në qafën e Valtanadhit, pasurohet me ujërat që rrjedhin nga kullota e Valtanadhit. Ky përroi formon dhe një segment të vijës kufitare ndërmjet Dhoksatit dhe Qesoratit.
- Përroi i Baltës së Kuqe (Dhioniseve)
- Përroi i Lopatishtit: përroi më i madh në fshat prandaj lehtësisht mund ta quajmë kryepërroi. Rrjedha e tij fillon në tokat e Qesoratit, në fund të kodrave të Levendeve. Hynë në tokat e Dhoksatit të Rrapi i Dudit. Në verë ka pak ujë dhe shërben për ujitjen e arave të Lopatishtit dhe të Sinive.
- Përroi i Frashnjetit: nuk ka burim të mirëfilltë. Ai mbledh ujërat e kullimit të kodrave të Shën Triadhës, kodrave të Petrovecit, kalon përmes Fushës së Frashnjetit dhe derdhet në Nimicë. Është përroi i përkohshëm pasi në verë shteron.

Rrjeti kullues

Fshati Dhoksat ka patur një shtrirje urbanistike të nivelit të mirë si rezultat i ndërtimeve dhe shtrirjes gjeografike të favorshme të vetë fshatit. Kanale kulluese ka në rrugën automobilistike që lidh Gjirokastrën me fshatin Dhoksat. Burimet e ujit të pijshëm janë të sistemuara në kanale kulluese që shërbejnë për vaditje.

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Në bazë të ligjit 7501 “Për tokën” dt. 19.07.1991 në kuadër të reformës për tokën bujqësore janë ndarë 124 ha për 158 familje me 595 banorë ndërkohë që mbetën për tu ndarë edhe 206 ha.

Besimi fetar

Popullsia e këtij fshati më herët se viti 1431 përbëhej nga tre grupe etnike, autoktone lunxhote orthodoxe, vllahë orthodox dhe labë të besimit musliman bektashi.

Edhe pse në gjendje të rënuar dhe jo funksionale, historia tregon për egzistencën e disa kishave si:

- Kisha Shën Thanas
- Kisha Shën Maria

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

- Kisha Shën e Premtja
- Kisha Shën Triadha
- Kisha Shën Kolli
- Kisha Shën Mëhilli (në proces rindërtimi)

Kultura dhe Turizimi

Banorët e këtij fshati në vite personifikohen nga kostumi i rrallë popullor “Lunxhe” dhe Ansambli i Këngëve dhe valleve “Lunxhëria”.

Për 4 vite me radhë, festivali shumëplanësh i traditës së zonës së Lunxhërisë “Divani Lunxhiot” mbledh grupe folklorike nga Shqipëria dhe viset e saj. Në këtë festival përcillen traditat e bukura të folkut shqiptar, pa lënë pas dhe veshjet popullore nga zonat e ndryshme një pasuri e vyer e Shqipërisë e cila falë aktiviteteve të tilla po vijon të tejçohet ndër breza.



Figura 9 Veshje karakteristike Lunxhote



Figura 10 Grupi i këngës Lunxhote

Monumente të trashëgimisë kulturore:

Në fshatin Dhoksat ndodhen dy monumente të trashëgimisë kulturore të llojit "Arkitekturë", të miratuara me numër “1886 10.06.1973”.

1. Kroi i lagjes së poshtme
2. Kroi me bendin e çetës së mesme



Figura 11 Kroi i lagjes së poshtme

1.2 Fshati Zhulat

Njësia Administrative Cepo

Vendndodhja

Fshati Zhulat ndodhet në një zonë të thellë malore në Komunën Cepo të Gjirokastrës në jug të Shqipërisë në pjesën perëndimore të aksit Tepelenë-Gjirokastrë. Shpatet e maleve dhe kodrave përreth tij janë të mbuluara me vreshta në të cilat ndodhen rreth 200 shtëpi të vendosura pranë një fortifikimi natyror tepër mbrojtës. Fshati Zhulat shtrihet në një sipërfaqe prej 3377 ha.



Figura 12 Pamje e fshatit Zhulat nga sateliti

Historia

Përreth Zhulatit ka gjurmë të dukshme nga të gjitha periudhat historike të njerëzimit: nga prehistoria, antikiteti, romakët, Bizanti, krishtërimi, mesjeta osmane, pavarësia, monarkia, antifashizmi, komunizmi dhe demokracia. Mbështetur në ato pak kërkime arkeologjike, këtu gjenden objekte e ndërtime të shumë periudhave historike të zhvillimit njerëzor. Kronikat e vjetra për fshatin Zhulat dikur e përmendin atë me emrin Julius, dikur Zhul.



Figura 13 Fshati Zhulat

Kështjellën e Zhulatit e ka themeluar mbreti i Spanjës kur këta banorë ishin aleatë të tij. Më vonë, me dredhi e shtiu në dorë Duka i Venedikut e më pas në shekullin e Bajazitit të shenjtë, e zптоi Qedik Ahmet Pasha. Kështjellë e pashembullt në bukuri, të cilës mund t'i përngjasë ajo e Kordusit ose ajo e Benefshes në Peloponez. Në të dallohen rrënojat antike, gurët prehistorikë, mulliri i vjetër etj.



Figura 14 Në Piri, mur fortese mijëra vjeçar



Figura 15 Rrënoja banese mijëra vjeçare

Në vitin 1081, siç thotë edhe historia, Papa Zhuli nga Zhulati bëri kanunin e parë në jugun e Shqipërisë, i cili rreth 700 vite më vonë u reformua nga Idriz Sulli, busti impresionues i të cilit qëndron në qendër të fshatit. Kanuni i Idriz Sullit që shërbente deri në Çamëri, ndalonte gjakmarrjen, lejonte divorcin dhe daljen e grave në punë e shumë elementë të tjerë që sollën zhvillim të madh për zonën.

Gjeografia

Fshati Zhulat ndodhet në perëndim të qytetit të Gjirokastrës në një distancë 27 km prej qytetit në kordinatat me gjerësi gjeografike 40° 07' 11'' Veri dhe gjatësi

gjeografike 19° 59' 20'' Lindje me lartësi 350 m mbi nivelin e detit. Qendra e fshatit quhet Baltës.



Figura 16 Qendra e fshatit që dikur mbante rrapin 500-vjeçar

Kufijtë

Fshati Zhulat kufizohet me fshatrat e tjerë si Fushëbardhë, Taroninë, Kolonjë, Golem, Kaparjel (Gjirokastrë), Tatzat (Delvinë) Borsh dhe Fterrë (Himarë).

Popullsia

Zhulati, në mesin e viteve 50-të të shekullit të shkuar, ishte një fshat me rreth 150 shtëpi. Më përpara këtyre viteve ka qenë më i madh, në mos më i madhi në zonën e Kardhiqit, këtej e matanë lumit. Në vitin 1923 kishte 137 shtëpi, 409 banorë, nga të cilët 396 myslimanë dhe 13 orthodoxe. Në shifra statistikore në këtë fshat regjistrohen rreth 850 banorë por aktualisht gjenden vetëm 250 banorë.

Arsimi dhe Shëndetësia

Pushteti i ri popullor, i dalë nga Lufta Nacionalçlirimtare, shpaloste programin e tij që, veç shumë të tjerave, për zhvillimin e arsimit e të kulturës hodhi dhe parullën epokale “Asnjë analfabet në Shqipërinë e re”. Shkolla u ndërtua me punë vullnetare nga zhulatasit. Të gjitha zërat që parasheh një ndërtim, e sidomos në zona të thella, me vështirësi të shumta, që nga themelet, gjatja e transportimi i gurit dhe lëndës drusore, nga largësi e terren të thyer, me kafshë e më shumë me krahë, gjetja e gurit për gëlqere, që zhulatasit i kishin nxjerrë një vit më parë. Aktualisht në fshat ka shkollë 9-vjecare ku përfshihen arsimi parashkollor, fillore dhe arsimi i mesëm i ulët.

Në këtë fshat funksionon qendra shëndetësore në të cilën kryejnë shërbimin një infermier, një mami dhe një mjek i cili shkon dy herë në javë.

Ekonomia

Ekonomia e kësaj zone mbështetet kryesisht në sektorin e blegtorisë, mbledhja dhe tregëtimi i bimëve medicinale dhe nga emigracioni.

Bujqësia: Toka e ndarë me ligjin 7501 është e pakët në sasi (vetëm 1 dynim për banorë), jo shumëpjellore (tokëkodrinore), dhe akoma nuk është bërë azhurnimi (duke bërë të pamundur marrjen në pronësi), faktorë që ndikojnë për mos zhvillimin e këtij sektori.

Blegtoria: Ky sektor është i zhvilluar mirë dhe përbën një nga sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të kësaj zone. Në fshatin Zhulat numerohen rreth 7000 krerë të imta, 300 krerë gjedh dhe rreth 100 krerë kafshë pune (mushka, kuaj, gomerë).

Kullotat: Kullotat janë të ndara në verore që zënë një sipërfaqe prej 714 ha dhe dimërore që zënë një sipërfaqe prej 297 ha. Gjithashtu, vetë fshati ka një sipërfaqe kullësore (musha) prej 250 ha.

Pemëtaria: Kryesisht në këtë zonë mbillet rrush, dardha, ftonj, kumbulla dhe arra. Nuk ka punishte, por përpunohen në mënyrë artizanale dhe në kushte familjare.

Pyjet: Në territorin e fshatit Zhulat ka sipërfaqe të konsiderueshme me pyje dhe kullota. Pyjet publike zënë një sipërfaqe prej 972 ha, zona e mbrojtur (Parku Kombëtar i Panjës) zë një sipërfaqe prej 508 ha.

Rrjeti rrugor

Këdo që të takosh në fshatin Zhulat menjëherë do të artikuloj problemin e rrugës, hall ky i përbashkët i të gjithë banorëve. Qendra e fshatit Zhulat nga aksi rrugor kombëtar (në ndërtim) Kardhiq-Sarandë është 6 km larg dhe segmenti rrugor që i bashkon është në gjendje jo të mirë. Shtresa rrugore është e shtruar me stabilizant natyror, dhe ka dy vepra arti (ura me hap drite deri 30 m) në gjendje të mirë. Komunikimi me fshatrat e tjerë që janë në kufi me fshatin bëhet vetëm nëpërmjet këtij segmenti rrugor.

Rrjeti ujor

Uji i pijshëm: Fshati furnizohet me një linjë ujësjellësi i cili merr ujin nga burimet e fshatit Kaparjel dhe me rrjedhje të lirë e çon në tre depo nga ku shpërndahet uji për çdo familje.

Liqene (Ujëmbledhësa): Në fshatin Zhulat nuk ka liqene apo ujë mbledhësa për vaditje apo natyral, por në malin e fshatit ka disa lera në funksion të blegtorisë.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Lumenjtë: Në fshatin Zhulat kalon shumë afër lumi i Joshe, ku shumë pranë ndodhet edhe një shkëmb masiv në një formë të veçantë të quajtur Guri Gjatë.



Figura 17 Guri i gjatë në anën e djathtë të shtratit të lumit



Figura 18 Lumi Joshe në fshatin Zhulat

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Në vitin 1991 banorët e fshatit Zhulat kanë përfituar tokë bujqësore me ligjin nr. 7501, gjithsej 88 ha. Kjo sipërfaqe toke bujqësore u nda për 171 familje bujqësore që banonin në fshat më 1991 dhe përfitues janë 880 anëtarë, me një normë mesatare prej 1000 m²/ frymë.

Besimi fetar

Një dëshmi e rrallë e tolerancës mes banorëve është edhe fakti i njohur dhe pranuar nga të gjithë se në Zhulat ka patur një bashkëjetesë ndërjetare të gjatë të banorëve me besime të ndryshme fetare, të krishterë dhe myslimanë por ndoshta edhe katolikë.



Figura 19 Xhamia e fshatit Zhulat

Fshati Zhulat është i përbërë nga një komunitet ku janë prezente dy lloje besimesh, ai musliman (sekti bektashi), dhe besimi ortodoks sot pjestarët e këtij besimi janë larguar plotësisht, por vlen të përmendet harmonia e shkëlqyer fetare që ka ekzistuar në këtë komunitet. Objekte fetare në fshat janë një teqe

Bektashiane e rindërtuar, dhe rrënojat e një kishe ortodokse.

Kultura dhe Turizmi

Mes shtëpive të rinovuara ka edhe shumë të tjera që kanë ruajtur strukturën e dikurshme e që flasin për të shkuarën. Ende dallohen gjurmët e kalasë së vjetër hijerëndë ku sipas studjuesit Vladimir Qirjaqi i ka fillesat e saj që në shekullin e dytë dhe të tretë para Krishtit, ku përforcime të tjera janë bërë edhe gjatë periudhës së mesjetës. Edhe pse shumë e dëmtuar ajo mbetet një vlerë e shtuar e Zhulatit historik. Sahati i fshatit është marrë në vitin 1913 dhe është nxjerrë jashtë shtetit. Në fshat janë aktive dhe zhvillojnë aktivitete të herë pas hershme dy grupe folklorike, të cilat ruajnë traditën e vjetër të isopolifonisë dhe të valleve popullore.



Figura 20 Kostumi dhe vallja tradicionale e krahinës

Vlen për t'u përmendur dhe aktiviteti i skulptorit Murat Kerra, një profesionist i mirëfilltë për skulpturën në dru, i cili e zhvillon aktivitetin e tij në fshatin Zhulat. Shtatorja e Idriz Sulit e gdhendur në dru, e cila është një vepër e madhe arti dhe një simbol i rrallë i historisë dhe kulturës kombëtare. Kjo vepër është e gdhendur në trupin e trungut të një rrapit historik që ka qëndruar aty për rreth 500-600 vjet në qendër të fshatit Zhulat si simbol i qëndresës dhe kuvendeve të fshatit dhe krahinës.



Figura 21 Vepër e Skulptorit Murat Kerra nga rrapi 500 vjeçar, figura e Idris Agë Sullisë

Zhulati është padyshim një nga atraksionet turistike më interesante të lumit të Kardhiqit. Një vendbanim gati dymijëvjeçar që fsheh në vetvete thesare të pazbuluara që presin të shohin dritën e diellit. Alternimi i bukurive alpine me historinë, polifoninë e kulinarinë e zgjedhur po e bëjnë Zhulatin – sofrën e

preferuar të dhjetra “udhëtarëve” të huaj.

Rreth 4 km larg nga fshati fshihet zona e Piriut që sipas arkeologut Vladimir Qirjaqi, ashtu si edhe kalaja e Zhulatis daton që në shekujt tre dhe dy para Krishtit. Asnjë punim nuk është bërë për këtë zonë të rëndësishme historike dhe njihet shumë pak nga studjuesit dhe organet kompetente. Zhulati mjafton ti thuash emrin për ta lidhur me shekujt. Është një vend që jo vetëm do rridhte zhvillim por edhe grupe turistësh që do të gjenin këtu shumëçka nga historia identitare shqiptare. Ka kala, ka vendbanim historik, ka banorë mikpritës dhe një traditë të pasur shekullore.



Figura 22 Zhulati vizitohet nga turistë të huaj

1.3 Njësia Administrative Antigone

Vendndodhja

Njësia administrative Antigone shtrihet në krahinën e Lunxhërisë dhe përbëhet nga pesë fshatra. Kjo zonë shtrihet në një sipërfaqe rreth 2800 ha, prej së cilës 771 ha janë tokë e kultivuar.

1. *Fshati Asim Zeneli*
2. *Fshati Arshi Lengo*
3. *Fshati Krina*
4. *Fshati Tranoshishtë*
5. *Fshati Saraqinishtë*




Figura 23 Njësia administrative Antigone, pamje nga sateliti

Historia

Antigonea antike ka mbërritur deri në ditët tona me emrin e një përmbledhje fshatrash me emërtime dëshmorësh por qyteti antik i Antigonesë u themelua nga Pirro, mbreti i Molosëve, në vitin 295 para Krishtit. U pagëzua me këtë emër për nder të gruas së tij, Antigonës. Sipas historianit grek të lashtësisë, Plutarkut, Antigonea qe qyteti që u lind nga dashuria dhe u shkatërrua nga urrejtja. Është themeluar në shek IV p.k, qytet që jetoi vetëm 100 vjet dhe u shkatërrua nga romakët si hakmarrje ndaj përkrahësve të Aleksandrit të Madh. Antigonea u



zhvillua si një qendër e rëndësishme ekonomike, sociale, kulturore dhe politike dhe në fund të shekullit të 3-të dhe në fillim të shekullit të 2-të para Krishtit mori formën e

Figura 24 Parku arkeologjik i Antigonesë

“polis” (qytet – shtet) dhe u kthye në një nga vendet më të rëndësishme të antikitetit. Antigonea për shkak të pozicionit të vendosur në një kodër dominuese të quajtur Jerma në qendër të luginës së Drinos, rajon i njohur në antikitet për shkak të popullimit me rreth 29 qendra banimi antike, fortifikime, varre monumentale, tempuj të lashtë dhe teatro, ka qenë qendra kryesore e luginës mes qendrave të tjera si Seloja që ndodhet në Dropullin e Sipërm në pjesën jugore të luginës, Hadrianopoli dhe Melani në qendër e deri lart në Palokastër e Lekël që ndodhen në pjesën veriore të luginës. Pas shkatërrimit nga romakët, qyteti u braktis për disa shekuj dhe vetëm në shekullin VI mbas Krishtit brenda tij u ndërtua një kishë paleokristiane. Në vitin 1963 shpallet monument kulture nga rektorati i Universitetit të Tiranës mbështetur në ligjin e asaj kohe. Në vitin 2005, konkretisht më 31.03.2005 në VKM nr. 396 është shpallur Park Arkeologjik. Zbulues i Antigonesë njihet Dhimosten Budina, një ndër ish ekspertët e Institutit Arkeologjik. Merita e rizbulimit dhe identifikimit të qytetit i përket arkeologut të shquar shqiptar Prof. Dhimosten Budina, i cili në periudhën midis viteve 1965 – 1988 udhëhoqi rreth 25 ekspedita arkeologjike të cilat nxorën në dritë një informacion të jashtëzakonshëm nga ky qytetërim antik.

Gjeografia

Antigonea shtrihet në lartësinë maksimale 800 m mbi nivelin e detit në fshatin Saraqinishtë, ndërsa më e ulëta arrin 150 – 200 m në fshatin Arshi Lengo. Zona ku ndodhet Antigonea nga pikëpamja klimaterike përshihet në zonën klimaterike mesdhetare malore, nënzona jugore.

Kufijtë

Njësia administrative Antigone kufizohet në veri me komunën që mban emrin e krahinës, Lunxhërinë, në jug dhe jugperëndim me lumin Drino, nga lindja dhe juglindja me Komunën Qendër Libohovë.

Popullsia

Numri i popullsisë së kësaj zone është 1850 banorë, me 440 familje. Njësia Administrative Antigone ka një popullsi etnokulturore të përzier:

- Popullsi myslimane e ardhur kryesisht nga viset e Kurveleshit para viteve '90, si dhe popullsi e ardhur pas viteve '90 nga Skrapari, Përmeti, Tepelenë etj.
- Popullsi autoktone që janë lunxhiotët, 100% e pastër në fshatrat Krinë dhe Tranoshishtë si dhe gati 50 % në fshatin Saraqinishtë.
- Popullsi vllahe e ardhur nga fundi i viteve '50 e vendosur në fshatin Saraqinishtë.



Figura 25 Shtëpia me peristil, shek. III para Krishtit

Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi i këtyre komuniteteve përbëjnë një krenari për zonën dhe bazë për zhvillimin në të ardhmen.

Arsimi dhe Shëndetësia

Njësia Administrative Antigone shquhet për arsimimin e vazhdueshëm të banorëve të saj, ku kanë mbaruar universitetin ndër vite rreth 280 studentë, në degët mësuesi, inxhinieri, shkolla ushtarake, mjekësi, shkencat e natyrës, Instituti i arteve dhe sporteve etj. Kjo ka ndikuar edhe në mirëqënien ekonomike të fshatrave. Sot ndjekin arsimin e lartë rreth 38 veta. Deri në vitet '90, vetëm në fshatin Asim Zeneli përfunduan arsimin e lartë 140 djem dhe vajza, të mendosh që në këtë vit ky fshat nuk kishte ende 40 vjet nga themelimi i tij. Ndërsa sot nuk ka familje pa një djalë apo vajzë që të mos ketë përfunduar arsimin e lartë.

Në njësinë administrative Antigone ushtrojnë funksionin e tyre tre qendra shëndetësore me personel të kualifikuar konkretisht:

- 1 qendër shëndetësore në fshatin Asim Zenel
- 1 qendër shëndetësore në fshatin Arshi Lengo

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

- 1 qendër shëndetësore në fshatin Saraqinishtë

Ekonomia

Zona është e orientuar ekonomikisht në vreshtari, bujqësi, blegtori, turizëm familjar dhe bletari.

Bujqësia:

Njësia Administrative Antigone ka kushte për kultivimin e të gjitha perimeve dhe zarzavateve. Bujqësia kryesisht ka qenë e orientuar drejt prodhimit të grurit si dhe jonxhë për bagëtinë kurse në pemëtari kultivohen kryesisht ullinj, lajthi dhe arra.

Blegtoria:

Zona e Antigonesë është e prirë kryesisht ndaj rritjes së bagëtive si dele, dhi dhe lopë. Kjo zonë është e ndërthurur me fusha, kodrina dhe male dhe kjo bën që prodhimi “bio” bujqësor dhe blegtoral të jetë nga më të mirët në zonë.

Pyjet dhe Kullotat:

Njësia Antigone përshkohet nga 224 ha pyje kurse kullotat ndahen në 50 ha verore dhe 50 ha dimërore përkatësisht në fshatin Tranoshishtë, Saraqinishtë dhe në Krinë. Ndonëse nuk bëhet fjalë për sipërfaqe pyjore të konsoliduara, një numër i kufizuar ekzemplarësh lisash dhe dushqesh shtatlartë të shpërndarë në mënyrë të çrregullt në krejt territorin e parkut dhe prania e një morie shkurresh mesdhetare, krijojnë në Antigone një pejzazh të papërsëritshëm natyror. Llojet kryesore janë lisi dhe qarri, por brenda tyre haset edhe krekëza. Në hapësirat e tjera, sidomos në Përroin e Tranoshishtës, në Ladovishtë dhe përreth Saraqinishtës, rriten edhe lloje të tjera si frashëri, thana, lajthia, panja me gjethe të gjerë. Nga shkurret mesdhetare në këtë mjedis hasen; kulumbria, qelbësi, cërmedeli, lofata dhe vidhi.

Rrjeti Rrugor

Aksi kryesor tashmë i asfaltuar falë pozicionit dhe shtrirjes i përshkon të pesë fshatrat e komunës, gjë që ndikon për daljen më shpejt të tyre në treg dhe lidhjen zinxhir të fshatit me fshat. Gjatësia e rrugës nacionale nga Ura e lumit deri në fshatin Saraqinishtë është 12 km. Parku Arkeologjik i Antigonesë ndodhet fare pranë qytetit të Gjirokastrës dhe rruga drejt këtij parku arkeologjikë është mjaft e mirë.

Figura 26 Kroj i madh në Saraqinisht

Rrjeti Ujor

Dendësia e madhe e rrjetit hidrografik këtu është e favorizuar nga disa faktorë: sasia e madhe e rreshjeve të rëna gjatë vitit, që e kalon shifrën 1700 mm, ndërtimi gjeologjik, pjerrësia e relievit dhe në disa zona mungesa e mbulesës së bimësisë.



Figura 26 Kroi i madh në Saraqinisht

Uji i pijshëm: Njësia administrative Antigone furnizohet me ujë të pijshëm nëpërmjet depove të ujit. Në këtë zonë ka burime ujore të pasura si burimi i Tranoshishtës dhe Lepushetit, të cilat mundësojnë furnizimin e të pesë fshatrave me rrjedhje të lirë.

Liqene (Ujëmbledhësa): Në zonën e Antigonesë, në afërsi të Asim Zenelit, ndodhet Ujëmbledhësi i Çinit me kapacitet 600.000 m³ ujë.

Lumenj-Përrenj: E gjithë zona ndodhet midis dy përrenjve të mëdhenj që fillojnë nga Mali i Lunxhërisë si dy degë të lumit Drino, “Përroi i Pesjakut” dhe “Përroi i Levendit”.

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Në bazë të ligjit nr. 7501 “Për tokën” dt. 19.07.1991 në kuadër të reformës për tokën bujqësore kemi këto të dhëna:

1. Fshati Asim Zeneli: numri i familjeve 109, numri i frymëve 887, toka gjithsej në ha 298, planifikuar për tu ndarë 208, ndarë në fakt 292, toka pa ndarë 6
2. Fshati Arshi Lengo: numri i familjeve 85, numri i frymëve 378, toka gjithsej në ha 140, planifikuar për tu ndarë 130, ndarë në fakt 130, toka pa ndarë 6
3. Fshati Krina: numri i familjeve 22, numri i frymëve 94, toka gjithsej në ha 100, planifikuar për tu ndarë 100, ndarë në fakt 88, toka pa ndarë 5
4. Fshati Tranoshishtë: numri i familjeve 20, numri i frymëve 74, toka gjithsej në ha 77, planifikuar për tu ndarë 65, ndarë në fakt 65, toka pa ndarë 12
5. Fshati Saraqinishtë: numri i familjeve 51, numri i frymëve 214, toka gjithsej në ha 156, planifikuar për tu ndarë 156, ndarë në fakt 95, toka pa ndarë 61

Besimi fetar

Në njësinë administrative Antigone egzistojnë këto objekte fetare:

- Kisha e Shën Kollit, e cila i përket vitit 1652
- Kisha e Shën Mërtirit, e cila i përket vitit 1617
- Manastiri i Shën Marisë në Spile, i cili i përket vitit 1634

Kisha e Manastirit të Shën Mërisë (Spiles) ndodhet në fshatin Tranoshishtë të njësisë administrative Antigone. Ky manastir është një monument i trashëgimisë i llojit "Arkitekture", i miratuar me numër "1886 10.06.1973".

Kultura dhe Turizmi

Përsa i përket kulturës së zonës kryesisht mbizotërojnë traditat e Lunxhërisë me këngë dhe valle lunxhote.

Vende Turistike:

Parku Arkeologjik Antigonea: Qyteti arkeologjik ngrihet mbi kodrën e Jermës, në krahun e djathtë të rrjedhës së mesme të lumit Drino, në jugperëndim të fshatit Saraqinisht. Falë pasurisë historike dhe arkeologjike që mbart, tërheq gjithmonë e më shumë vizitorë vendas dhe të huaj. Përfshin një sipërfaqe urbane rreth 90 hektar të rrënojave të qytetit të lashtë Antigonesë, ka nisur të funksionojë si i tillë qysh në shtator të vitit 2006. Në monumentet e vizitueshme të tij me të cilat vizitori i ndesh qysh në hyrje të parkut, janë Akropoli, Nimfeu dhe një pjesë e madhe nga fragmentet solide të murrit rrethues rreth 4 000 m gjatësi, një fortifikim impresionues që e mbronte qytetin nga të gjitha anët, veçanërisht në pjesën jugore dhe perëndimore ku rreziku ishte më i madh për shkak të terrenit.



Figura 27 Muret e Kalasë së Paleokastrës



Figura 28 Porta hyrëse e qytetit të Antigonesë

Vizitori në Antigone mahnitet, jo vetëm me muret fortifikuese dhe rrënojat e shtëpive të djegura brenda një nate dhe të ndërtuara 2 300 vjet më parë me

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

blloqe të mëdha guri gëlqeror, të marra nga gurorja e malit të Lunxhërisë, por vizitori aty impresionohet si askund tjetër me zhvillimin e rregullt urbanistik dhe arkitekturor. Pjesët e zbuluara nga ekspeditat arkeologjike të rrugëve, shëtitoreve, trotuareve, kanalizime, punishteve, krojeve, objekteve publike, japin për studiuesit e antikitetit dhe vizitorët kureshtarë një ide të plotë të planifikimit urban të qytetit, duke treguar se Antigonea është ndërtuar me një dekrete të posaçëm të Pirros dhe rregullat urbanistike janë respektuar me rigorozitet ndër vitet e tjerë të qytetëtimin antigonas. Vitet e fundit turistët dhe vizitorët vendas dhe të ardhur nga vende të tjera kanë treguar interes për të parë e vizituar Antigonenë për shumë e shumë motive.



Figura 29 Teatri i Adrianopolit



Figura 30 Muri i anës jugore

Por, interesi, shërbimet dhe lehtësitë për vizitorët shkojnë edhe më tej me disa shërbime ekstra që kryhen nga vetë komuniteti i banorëve të zonës, sikurse janë shtegu apo udha për vizitorët që duan të shkojnë më këmbë apo me gomar nga qendra e komunës deri në park, mundësia e një vizite interesante të punishtet e përpunimit tradicional qumështit të deleve dhe të leshit “Artizanet e Antigonesë”, mundësi për fjetje sipas dëshirës, vizita të tjera në monumentet e kulturës jashtë parkut, si Kisha e Shën Kollit Saraqinishtë, Manastiri dhe kompleksi shpellave të Spilesë, vizita në familjet bujare mikpritëse të fshatrave të reja të ngritura gjatë periudhës së komunizmit “Asim Zeneli” dhe “Arshi Lengo” apo të fshatrave autoktonë tradicionalë lunxhiotë: Krinë, Tranoshishtë dhe Saraqinishtë.



Figura 31 Gjatë gërmimeve arkeologjike



Figura 32 Rrënojat e qytetit



Thënë më qartë e në mënyrë të përmblodhur, në Antigone më lehtë se kudo gjetkë turisti dhe vizitori gjen qytetarinë shembullore, humanizmin, mjeshtërinë dhe dashurinë e madhe e paraardhësve dhe banorëve aktualë për jetën në komunitet, gjen turizmin e aventurës, ekoturizmin, gjen një komunitet lokal autokton të ndjeshëm dhe aktiv ndaj natyrës dhe vlerave të kulturës. Turisti perëndimor do të “prekë” në komunën e Antigonesë të gjitha periudhat historike të njerëzimit, prehistorinë (shpellat e Spilese dhe Ladovishtës), madhështinë e Antikitit (siti arkeologjik Antigone), fillimet e Krishtërit (3 bazilikat brenda sitit),

Figura 33 Rrapi i Tranoshishtës

misteret e Bizantit (Manastiri Eremit i Spilesë kisha e Shënkollit), arkitekturën e përkryer Mesjetare (banesat e shek 17 – 18 në Tranoshishtë), tendencat e periudhës komuniste në urbanistikë (fshatrat me emra dëshmorësh “Arshi Lengo” dhe “Asim Zeneli”).

Rrapi shekullor në fshatin Tranoshishtë: Ndodhet në qendër të fshatit Tranoshishtë. Një pemë qindravjeçare por e dëmtuar rëndë për shkak të një zgavre tejet të madhe në brendësi të saj, e shkaktuar nga një zjarr i vënë disa vitë më parë. Disa degë të tij janë rrëzuar nga erërat apo edhe për arsye të moshës.

Manastiri i Spilesë: Objekti fetar më i vjetër në rajonin jugor është Kisha dhe Manastiri i Shën Mërisë në Spile, rreth 2 kilometra në lindje të qytetit antik të Antigonesë. Daton në shek. XIV dhe ngrihet mbi një shkëmb konglomerat gëlqeror për shkak të shpellave karstike. Shtrihet në verilindje të njësisë administrative Antigone, në kufi me fshatin Qesorat të zonës së Lunxhërisë. Shpella ku ndodhet ky manastir, e quajtur “Shkëmbi i Madh” ka guva të punuara dhe të mbrojtura, ku mund të hipësh tek shkallët të cilat dikur përdoreshin për vetëflim. Në territorin e Manastirit të Spilesë ndodhet një kishë e mirëmbajtur dhe gati 600-vjeçare. Ky manastir e ka marrë emrin nga Shkëmbi i Spilesë që ndodhet në territorin ku bëjnë pjesë manastiri dhe kisha me të njëjtin emër.



Figura 34 Manastiri i Spilesë



Figura 35 Pjesë nga mozaiku i Bazilikës Paleokristiane

Porta e Netajve (në fshatin Saraqinishtë): Porta daton në fund të shekullit XIX, më e madhja në krahinën e Lunxhërisë, me gdhendje të ndryshme, si valltarë lunxhiotë apo lunxhiote, figura shpendësh apo kafshësh të ndryshme. Aktualisht mirëmbahet prej të zotëve të shtëpisë, por ka nevojë urgjente për t'u restauruar pasi përbën vërtet një vlerë të rallë.



Figura 36 Porta e Netajve

Zbulimi më i rëndësishëm i gjurmëve shumëvjeçare të Jermës ishte gjetja e 14 *teserave* prej bronxi, që mbajnë emrin e qytetit Antigonea. Teserat kanë trajtën e një monedhe 2 cm me trashësi 1 mm, ku rrotulla të ngjashme janë gjetur edhe në Dodonë e në Athinë.

Kjo gjetje dha mundësinë që të identifikoheshin rrënojat e kalasë së Jermës me qytetin e lashtë të Antigonesë. Objekte që përdorehin gjatë referendumeve nga banorët e që dëshmuajnë jo vetëm për sistemin politik me demokraci të drejtpërdrejtë, por këto gjetje të rralla shërbyen si dokumenti i parë epigrafiq, që identifikoi qytetin dhe që u krijoi mundësi arkeologëve që të korrigjojnë mendimin e shprehur më parë për këtë çështje.



Figura 37 Tesera e votimit

Kroi me Dy Harqe (në fshatin Saraqinishtë): Identifikohet si i tillë se ka dy harqe të mëdha dhe dy prurje burimi. Është një ndër objektet e rralla që shihet prej fshatarëve si mjaft i rëndësishëm. Përveç ujit të pijshëm, është përdorur edhe në ceremoni dasmesh dhe gëzimesh, si vendi ku nusja dhe dhëndri duhet të kalonin patjetër për t'u freskuar. Është një ndërtim që i përket shek XIX dhe është në gjendje disi të mirë por që kërkon ndërhyrje dhe mirëmbajtje.

1.4 Fshati Lazarat

Njësia Administrative Lazarat

Vendndodhja



Figura 38 Pamje e Lazaratit nga Sateliti

Lazarati shtrihet në shpatin lindor të Malit të Gjerë rreth 3 km në jug të qytetit Gjirokastrë, pranë Grykës së Sopotit, në lartësi 420 m mbi nivelin e detit, në pjesën perëndimore dhe 320 m mbi nivelin e detit, në pjesën lindore. Faqja e malit ku është pozicionuar Lazarati është mjaft e zhveshur. Shtrihet në tre këmbë të vogla mali, të ndara nga përrenj të vegjël që vërshojnë vetëm në kohën e shirave. Lazarati është fshati më i madh në rrethin e Gjirokastrës me një sipërfaqe rreth 4000 Ha. Kjo sipërfaqe shtrihet në kuotat 678 m mbi nivelin e detit.

Historia

Arkeologjikisht Lazarati identifikohet si qendër e banuar qysh në prehistorinë e hershme, paleolitin e mesëm (250 000 – 30 000 vjet para Krishtit). Si i tillë përfaqësohet në grupin e vendbanimeve të hershme të dëshmuara në vendin tonë. Dëshmitë që e identifikojnë Lazaratin si qendër banimi prehistorike përfaqësohen nga gjetjet e rastit ashtu dhe prej ekspeditave të organizuara nga Instituti Arkeologjik Tiranë të kryesuara nga arkeologu Ilir Gjipali (viti 2002). Sipas Çabejt për nga toponimia ky fshat hyn ndër katundet e fisit, duke e pasur emërtimin një lloj plurale kolektive nga pikëpamja gjuhësore Lazarat "pasardhësit e Lazarit".

Në dokumenta të ndryshme nga periudha e antikitetit dhe ajo romako-bizantine nuk është gjetur emri Lazarat dhe vetëm në regjistrimet e vitit 926 H figuron me emrin Sopot. Më vonë me spostimin e tij si vendbanim më në veri, rreth

Manastirit të Shën Lazërit figuron me emrin Manastir (Munishtir) dhe së fundi shek. XVI – XVII figuron me emrin Lazërat.



Figura 39 Mure të qytezës Dervene

Në pjesën jugore rreth vitit 1955 filloi ndërtimi i lagjes së re që njihet me emrin “Lënxtatë”. Kjo lagje ndahet nga fshati prej Përroit të Sopotit me gjerësi rreth 200 m duke u zgjeruar poshtë dhe mbi rrugën nacionale arrin 1.5 km gjerësi, duke zënë gjithësej një sipërfaqe rreth 100 ha. Në vitin 1965 filloi ndërtimi i një tjetër lagjeje poshtë Lëmit të Meme apo shkollës së vjetër. Fshati i vjetër përbehej nga tre lagje kryesore: në veri Lagjia e Gjoke, Lagjia e Mesit dhe Lagjia e Sopotit.

Gjeografia

Pozicioni gjeografik i këtij fshati, i vendosur në një pllajë kodrinore-shkëmbore në rrëzë të Malit të Gjerë, i jep disa veçori Lazaratit. Ka një klimë mesdhetare



ku temperatura më e lartë është arritur gjatë viteve 1951 – 1960 në 42.2° C ndërsa ajo më e ulëta në – 8° C. Rreth 90% e rreshjeve bien në muajt nëntor – dhjetor dhe mars – prill, shumë pak gjatë verës. Erërat më karakteristike janë ato nga Gryka e Sopotit dhe ato nga veriu.

Figura 40 Pamje nga fshati Lazarat

Kufijtë

Fshati Lazarat në pjesën veriore ndahet nga qyteti me perroin e Gjokanës, më poshtë me përroin e Fitazit, Vreshtat e Këputura nën Teqenë e Zallit në Zonën Industriale me banesa dhe biznese lazaratase deri në rrugën nacionale mbi varrezat e qytetit. Nga ana lindore ndërtimet dhe bizneset e Lazaratit kufizohen nga rruga nacionale Gjirokastrë – Kakavie.

Kufiri i fshatit nga perëndimi vazhdon majës së Sopotit – Makërxhime – Vajure duke zbritur kufiri verior në Gropë të Madhe – Hieja e Gjokanës, Përroi i Gjonakës - Ura e Karcaleve – Përroi i Fitazit, Vreshtat e Këputura deri në rrugën nacionale.



Figura 41 Bregu Spilos

Gjatë viteve të fundit shtimi i popullsisë ka diktuar zgjerimin e fshatit, i cili është shtrirë drejt lindjes mbi rrugën nacionale duke u bashkuar me Kordhocën, nga veriu gati bashkohet me qytetin e Gjirokastrës (vitet e fundit është shtrirë në gjithë zonën industriale), ndërsa në jug kufizohet me fshatin Dervician të krahinës së Dropullit. Kufijtë e fshatit ndahen natyrshëm nga rrjedhat e përrënjeve që rrethojnë territorin e tij.

Popullsia

Në regjistrimin e vitit 1431 Munishtiri ka 53 shtëpi me një popullsi prej 350-400 anore. Në vitin 1850 rezultojnë 80 shtëpi dhe afërsisht 500 - 600 banorë. Në regjistrin e vitit 1920, numri i shtëpive është dyfishuar dhe për 70 vjet ka arritur në 167 e po ashtu numri i banorëve në 854. Në vitin 1945 ishin 200 shtëpi me 1200 banorë ndërsa aktualisht janë 922 familje me 3450 banorë (74 banorë për km²). Lazarati është një trevë e banuar që në periudhën ilire. Kjo vërtetohet nga gjetjet arkeologjike si muret e vjetra ilire, monedha, varre të asaj periudhe dhe objekte të tjera. Familjet e fshatit e kanë origjinën nga fiset ilire dhe janë krijuar si pasojë e ndarjes së këtyre fiseve. Sipas vëzhgimeve janë rreth 49 fise.



Figura 42 Pamje nga fshati Lazarat

Ekonomia

Bujqësia: Kjo zonë dominohet përgjithësisht nga kultivimi i bimëve foragjere (jonxhë) dhe një pjesë e vogël e zë kultivimi i drithërave si grurë dhe tërshërë. Kështu rriten gjethe gjerët, lisi, shkoza, lajthia, bliri, mëllëza, rrapi, lofata, arra, dëllënja, gështenja; rriten shkurret si ferra, cfaka, gjineshtra etj. Gjithashtu rriten edhe një sërë bimësh mjekësore si çaji, murrzi, sherebeli, rigoni i gjatë dhe ai i malit, trëndafili i egër etj. Përsa i përket llojeve të pemëve që banorët e këtij fshati mbjellin i përkasin pemëve arvore nga të cilat rreth 15 ha janë lajthi dhe vetëm 3 ha arrë.

Blegtoria: Zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të kësaj zone. Aktualisht në fshat numërohen rreth 1100 krerë gjedh, 14000 krerë dele dhe 3000 krerë dhi. Ndodhen gjithashtu shpendë të egra si larashi, shqiponja, skifteri, laraska, mëllenja, pellumbi i egër, trumcaku etj. Nga kafshët e egra në zonën tonë gjenden lepuri, dhelpra, ujku, kunadhja, iriqi, urithi etj. Në Kordhocë (lagjja e poshtme e fshatit Lazarat) funksionon edhe një baxho për përpunimin e produkteve të qumështit.

Pasuritë nëntokësore: Një nga pasuritë e vlefshme nëntokësore të Lazaratit janë gurët gëlqeror që rrethojnë fshatin e në mënyrë të veçantë gurët e Mushajadhës ku me të drejtë studjuesit e gjeologjisë në Gjirokastrë i kanë vlerësuar si gurë dekorative. Është për t'u përmendur se me gurët e zonës së Dervicianit e Mushajadhës janë shtruar të gjitha kalldrëmet e qytetit të Gjirokastrës dhe shtëpitë përreth. Guri gëlqeror që ndodhet në territorin e fshatit plotëson parametrat për prodhimin e çimentos.



Figura 43 Fabrika e inerteve

Kullota: Aktualisht në këtë fshat përfshihen 2500 ha pronë shtetërore dhe private. Pasuri tjetër që duhet të vihet në dispozicion të biznesit vendas është shfrytëzimi me kriter i inerteve lumore dhe depozitimeve zallishtore si në pjesën veriore të fshatit ashtu dhe në krahun jugor të tij.

Pyjet: Toka duke qënë me pakicë mbi formacionet gëlqerore, nga gërryerjet si dhe nga shpërdorimi pa kriter i tyre gjatë shekujve janë zhdukur shumë sipërfaqe pyjore. Kështu sot Mali i Gjerë mbi fshat nga një mal i mbuluar me pyje lisi, shkozë, bliri, gështenje, frashëri etj. është kthyer në një zonë me pak pyje si Pylli i Sopotit, Pylli i Ristës dhe Pylli i Gjokanës që janë zhvilluar shumë në këto vitet e fundit. Sot gjenden vende me emra si Gështenjat e Jupe, Guri Furkave, Këmba e Lisave, Lisat e Bejke etj. por që janë të zhveshura tërësisht.

Arsimi dhe Shëndetësia

Në fshatin Lazarat funksionojnë dy shkolla të arsimit fillor, 9-vjeçar dhe të mesëm:

- Shkolla “Baba Rexhepi” e cila funksionon si shkollë fillore
- Shkolla “Muhamet Gjollesha” e cila funksionon si shkollë 9 – vjeçare dhe e mesme
- Shkolla “Kordhoc” e cila nuk është funksionale



Figura 44 Pamje nga shkolla “Baba Rexhepi”

Shërbimi shëndetësor në fshatin Lazarat kryhet në dy ambjente me personel infermier, konkretisht, një qendër shëndetësore në Lazarat dhe një qendër shëndetësore në lagjen Kordhoc e cila momentalisht është jashtë funksionit.

Rrjeti Rrugor

Fshati Lazarat ka një infrastrukturë rrugore e cila përbëhet nga rruga hyrëse në qendër të fshatit me gjatësi 2 km dhe rrugë dytësore të mirëmbajtura.



Figura 45 Qendra dhe rrugët e fshatit Lazarat

Rrjeti Ujor

Uji i pijshëm:

Furnizimi me ujë i banorëve të këtij fshati kryhet nga tre depo uji edhe pse në fshat numërohen shtatë të tilla. Aktualisht katër prej tyre janë jashtë funksionit. Në zonën fushore dhe rreth rrugës nacionale ka ujëra nëntokësore të cilat aktualisht shfrytëzohen për furnizimin me ujë të fshatit. Gjithashtu dhjetëra familje kanë bërë shpime dhe marrin ujë për vaditje e larje në zonën e Kordhocës mbi rrugën nacionale.

Lumenj – Përrenj:

Pasuria e rrjetit hidrografik të këtij fshati përbëhet nga dy lumenj (Drino dhe Suhë) dhe shtatë përrenj (Sopotit, Gjokan, Pllashnjë, Rivzuar, Mavrik, Gjokaj, Bezo). Gjatë rënies së shirave përrenjtë fryhen dhe shkarkojnë gërryeje, ku dalin dhe burime nëntokësore me ujë të bollshëm por të përkohshëm si Nivzori, Mavriku, Derrasa, Burimet e Ali Karajt, Bishti i Arrave dhe Burima e Gjonit. Në disa prej përrenjve më të mëdhenj, për të frenuar erozionin, janë ndërtuar prita të mëdha si në Përroin e Sopotit, Pllashnjës dhe Fitazit. Rreth fshatit ka mjaft burime uji që mbajnë ujë gjatë gjithë vitit si Draci, Kokojani, Përroi Çafos, Spilua, Burima e Qishës, Picunari, Burima e Gjoke etj. Pjesa më e madhe e tyre kanë pak prurje uji ku gjatë periudhës së verës bien ndjeshëm.



Figura 47 Lisi Varri i Dervishit

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Për banorët e fshatit Lazarat, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “*Për tokën*”, në kuadër të reformës për tokën bujqësore për 696 familje janë shpërndarë gjithsej 695 ha tokë bujqësore.

Besimi fetar

Fshati është i rrethuar nga objekte fetare e nga këta më i vjetri është Selgjikja e cila ndodhet në majën më të lartë të malit të Sopotit në drejtim nga lindja. Ky objekt kulti thuhet se është besuar që në lashtësi dhe vazhdon të besohet deri në ditët tona. Mendohet se fjala Selgjike do të thotë fatsjellës. Më vonë mendohet se aty ka qëndruar shenjtori bektashian Sari Sallteku me dy dervishët e tij. Kohët e fundit komuna e fshatit ka hapur rrugë automobilistike në terren të vështirë nëpër pyll në mënyrë që ky vend i shenjtë të bëhet lehtësisht i vizitueshëm nga njerëzit.



Sipas të thënave të pleqve aty nga viti 1740 në fshat është ndërtuar xhamia e parë, e cila vazhdoi të funksionojë deri në periudhën e komunizmit, kur u shkatërrua nga regjimi. Po rreth viteve 1750-1760 në

Figura 47 Vend i shenjtë Selgjike

Lazarat ka ardhur i pari klerik bektashian, Baba Zeneli i cili strehëj herë pas here në Brahimag që e kanë shtëpinë në qendër të fshatit. Kur ky klerik ndërroi jetë fshati ndërtoi Tyrbenë e Baba Zenelit, e cila është besuar dhe vazhdon të besohet ende si objekt kulti shumë i shenjtë i fshatit. Në këtë Tyrbe prej qindra vjetësh nga fisi i Brahime brez pas brezi është ndezur dhe vazhdon të ndizet çdo

natë qiri. Veç këtij në fund të fshatit ndodhet dhe një varr i madh i rrethuar me mure që quhet Varri i Dervishit, të cilin lazaratasit e besojnë dhe e mbrojnë nga dëmtimet, ndezin qirinj dhe hedhin monedha. Në kultivimin e besimit bektashian tek lazaratasit, veç klerikut të parë që thamë më lart një rol shumë të rëndësishëm kanë luajtur Teqja e Zallit, afër Gjirokastrës dhe Teqja e Melanit, afër Nepravishtës. Shumica e lazaratasve ishin muhibë të këtyre dy teqeve dhe kryenin në mënyrë rigorozë ritet e bektashizmit. Bektashizmi dhe Klerikët e tij siç dihet kanë qenë mbështetës të lëvizjes patriotike për pavarësi kombëtare dhe për përhapjen e gjuhës shqipe. Për këtë arsye pushtuesit grek gjatë evazionit të tyre, të parën shkatërruan Teqen e Zallit, si bazë e shqiptarizmit në Jug.

Në periudhën Romake kur në Ballkan u përhap krishtërimi, edhe Lazarati u përfshi nga kjo fe. Këtë e vërtetojnë toponimet me emrin kishë që gjenden brenda fshatit dhe përreth tij. Kështu kemi kishën e Gjoke, kishën e Meme aty ku është shkolla “Baba Rexhepi”, kisha e Kurune, kisha e Tene dhe kisha e Sopotit në Sopot. Të dhënat gojore flasin dhe për ekzistencën e një Mnastiri në baçen Seriane ku ka shërbyer At Lazri prej nga mori dhe emrin fshati në fillim Manastir e më vonë Lazër-At.



Figura 48 Teqja e Zallit

Kultura dhe Turizmi

Lazarati apo Sopot i dikurshëm në jug të Gjirokastrës është kufiri jugor i krahinës së madhe të Labërisë. Pra pjesë e një krahine me shtrirje gjeografike mjaft të gjerë në jug perëndim të Shqipërisë, në trevat e Konisë antike. Kjo krahinë ka veçori etnografike, gjuhësore kulturore e zakonore që e dallojnë nga zonat e tjera por edhe cilësi të përbashkëta me gjithë krahinat e Shqipërisë. Po ashtu dhe Lazarati ka veçoritë etno-kulturore të Labërisë por dhe veçori të tij që lidhen me pozicionin gjeografik shumë afër me qytetin e Gjirokastrës dhe krahinën minoritare të Dropullit.

Monumente kulture: Ura e Kordhocës, 4 km në juglindje të qytetit të Gjirokastrës (monument i kategorisë I) dhe rrënojat e urës së Shënkollajve



Figura 49 Ura e Kordhocës

Zbulime arkeologjike:

Objektet e gjetura në vendbanimin prehistorik të Lazaratit janë të njëjta me ato të gjetura në vendbanimet e tjera prehistorike në territorin e vendit tonë si në Xarë të Sarandës, Gajtan të Shkodrës etj. Inventari i gjetjeve përbëhet nga vegla prej guri dhe stërralli të punuara si dhe mbetje gurësh prej të cilave përfitoreshin veglat e hershme prehistorike.



Figura 50 Kulla 400-vjeçare

Vendbanimi i Dervene në grykën e Sopotit (fshati Sopot) ku janë varrezat ishte një vendbanim strategjik, në funksion të mbrojtjes të rrugës antike që lidhte qytetin e Antigonesë me atë të Finiqit (nëpërmjet grykës së Sopotit). Prania e mureve flet për një sipërfaqe ku përfshiheshin 33 ndërtesa, të vendosura rreth 25 hapa larg njëra tjetrës.



Figura 51 Gryka e Sopotit



Figura 52 Rrënojat e qytezës së Sopotit

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Historia e vendbanimeve të fortifikuara në segmentin Kordhocë – Sopot shpjegohet me pozicionin strategjik që zinte në atë kohë Gryka e Sopotit për lëvizjen dhe zhvillimin ekonomik midis Antigonesë e luginës së Drinos dhe pellgut të Foinikës (kryeqytet i Epirit). Gryka e Sopotit ishte rruga më e shkurtër që lidhte këto dy treva.

2. BASHKIA LIBOHOVË

2.1 Fshati Labovë e Sipërme

2.2 Fshati Nepravishtë

2.1 Fshati Labovë e Sipërme

Njësia Administrative Qendër Libohovë

Vendndodhja

Fshati Labovë e Sipërme shtrihet rrëzë malit Bureto në rrethin Gjirokastrë. Një vend që për shkak të historisë mistike, të larmishme dhe të lavdishme, njihet me disa emra; Labovë e Poshtme dhe Labovë e Sipërme (emërtimi i dy pjesëve të të njëjtit vendbanim), Labovë e Kryqit (emërtim që lidhet me praninë e një kishe të vjetër bizantine dhe të një kryqi që tani është zhdukur dhe Labovë e Libohovës (për ta dalluar nga Labova e Vangjel Zhapës që ndodhet në Odrie në veri të Lunxhërisë. Sipërfaqja e përgjithshme e këtij fshati është rreth 14 km².



Figura 53 Pamje e fshatit Labovë e Sipërme nga sateliti

Historia

Që nga lashtësia e hershme, në gjithë hapësirën e kësaj treve kanë jetuar fiset ilire të Kaonëve, të cilët, sipas të dhënave arkeologjike, i kanë shtrirë banimet e tyre në këto dy krahina nga Antigonea në jug të trevës, e gjer në Mavrabel e Lekël, në veri të saj.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Pushtimet osmane të mesjetës i kanë bashkuar banorët e këtyre krahinave në një luftë të ashpër e të vazhdueshme. Kalatë e ngritura në Lekël, Shëndëriadhë e gjetkë, i kanë angazhuar banorët e tyre në një qëndresë të fortë, Në periudhën e sundimit turk ka qenë e përbashkët për të dyja krahinat edhe lufta për arsimin e gjuhën shqipe. Krahas gjuhëtarëve patriot tunxhi,otë Pandeli Sotiri nga Selcka dhe Koto Hoxhi nga Qestorati, jehonë të madhe pati brenda dhe jashtë vendit edhe hapja e shkollës së parë shqipe në Labovë, në prill 1910 nga patrioti Nane Panajot Meksi.

Gjeografia

Kjo krahinë shtrihet 557 - 700 m mbi nivelin e detit, në shpatin perëndimor të malit të Buretosme një reliev përgjithësisht kodrinor ku mbizotëron klima mesdhetare.

Në vargmalet në të cilat shtrihen të dyja krahinat e Labovës, priten si me shpatë nga dy gryka: gryka e Mezhgoranit apo e Këlcyrës në veri dhe nga gryka e Selckës në jug. Në secilën nga këto gryka derdhen edhe dy lumenj, lumi i Vjosës në veri dhe lumi i Suhës në jug.

Kufijtë

Zona e këtij fshati kufizohet me fshatin Libohovë, fshatin Suhë, fshatin Selckë, fshatin Hllomo dhe Çatistë.

Popullsia

Aktualisht në fshat numërohen rreth 220 banorë dhe 110 familje. Emigracioni ka prekur pothuajse çdo familje të këtij fshati.

Arsimi dhe Shëndetësia

Aktualisht në fshatin Lobovë e Sipërme funksionon një shkollë fillore dhe dy qendra shëndetësore.

Ekonomia

Burimet e jetës labovite janë vreshtaria, bagëtia, mbledhja e bimëve medicinale dhe emigracioni. Tani së fundi ka lindur ndër banorët dëshira për turizëm kulturor dhe rural.

Bujqësia: Në këtë zonë, në pjesën poshtë kodrave dhe në fusha rritet frutikultura dhe bimët e arave. Ndërsa në brezat lart fshatrave shtrihen masive kullusore, më tej shkurret, e mbi to, lart, pyjet jo fort të dendura. Në malet e kësaj treve rritet çaji, trëndelina, sherebeli e bimë të tjera medicinale. Rreth 70% e tokës është kryesisht foragjere kurse perime dhe vreshta rreth 80 ha.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Pemëtaria: Kryesisht në këto treva mbillen arrë, mollë, lajthi, gështenja, ullinj 5 ha dhe rreth 80 ha rrush.



Figura 54 Pamje nga fshati Labovë e Sipërme

Blegtoria: Numërohen rreth 100 lopë, 1200 dele, 100 dhi dhe 25 njëthundrakë.

Kullota: Në këtë zonë kullotat shtrihen në rreth 1200 ha tokë.

Rrjeti Rrugor

Rrugët që të çojnë në fshat janë kryesisht të papërfundara. Distanca e fshatit nga rruga kryesore është 9 km, ku 5 km është e asfaltuar dhe 4 km e paasfaltuar.



Figura 55 Rrugët në fshatin Labovë e Sipërme

Rrjeti ujor

Në vargmalet në të cilat shtrihen të dyja zonat e Labovës burojnë ujërat jetëdhënëse, duke filluar nga Gurra e Leklit, ajo e Hormovës, e Labovës, nga burimet e Hosit dhe vazhdojnë me ato të Serpenit, Gurra e Këllëzit, burimet e Dhoksatit, Qestoratit e gjer te burimet e Lepushetit të famshëm mbi Saraqinishtë e Stegopul.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Nga burimet e Hosit furnizohen jo vetëm fshatrat e Karjanit, Kakozit, Valaresë dhe Gjirokastrës e më gjerë, por edhe Labova, sidomos për vaditjen e tokave të Mavrambelit e të Nënëgurëve.

Uji i pijshëm: Popullsia e kësaj zone furnizohet me ujë të pijshëm nëpërmjet ujësjellësit.

Liqene (Ujëmbledhës): Është në funksion një ujëmbledhës 2 ha me kapacitet rreth 90.000 m³.

Lumenj–Përrenj: Në këtë zonë rrjedh Lumi i Suhës, përroi i Gogodarit dhe përroi i Gudubiri.

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Për banorët e fshatit Labovë e Sipërme, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, në kuadër të reformës për tokën bujqësore për 312 ha janë shpërndarë gjithsej 250 ha tokë bujqësore ndërsa pjesa tjetër është e pandarë.

Besimi fetar

Fshati Labovë e Sipërme njihet në historinë e saj nga ekzistenca e kishës së “Shën Marisë” por jo vetëm. Në këtë zonë ka 32 kisha dhe 4 manastire si Manastiri i Shën Thomait me gurë pellazgjik, manastiri i Kociut, manastiri i Shën Gjergjit dhe manastiri i Shënkollit.

Kultura dhe Turizmi

Në këtë zonë mbizotërojnë kryesisht traditat e Lunxhërisë me valle dhe këngë Lunxhiote.

Monumente të trashëgimisë kulturore:

Kisha e “Shën Marisë” sipas ciceronëve të kësaj zone “... kjo nuk është kishë si gjithë të tjera, kjo është shumë e lashtë, është si legjendë me shumë enigma...” Nga jashtë ndërtesa paraqet një arkitekturë të mënyrës më tipike bizantine, me një kupolë të lartë qendrore, me neft të rregulluar dhe përforcuar me kondrafort. Një narteks i ndërtuar më vonë siguron hyrjen kryesore. Në muret e brendshme, specialistët ikonografë dallojnë rreth nëntë nivele të dallueshme të pikturës afreske. Kisha ashtu sikurse e shikojmë sot, në thelb, sipas ekspertëve është një krijim i shekullit të X-XI të erës sonë, ndërtuar ndoshta në periudhën e sundimit



të Despotatit të Epirit, ndonëse ndërtimi në një themel më origjinal mendohet se mund të shkojë deri në vitet 527-565 në periudhën e mbretërimit të Perandorit Justinian, me të cilin ata lidhin edhe legendën e kryqit të vërtetë të grabitur në vitin 1989.

Figura 56 Kisha e Shën Marisë

Kalaja e Labovës së Kryqit, e shpallur Monument Kulture i Kategorisë së Parë në vitin 1963, ndodhet pranë fshatit. Fortifikimi është ndërtuar në një masë shkëmbore të shkëputur prej malit

Bureto në perëndim të Labovës. Ky vendbanim identifikohet nga studiuesit edhe me emrin Paleokastër, pasi kodra mban këtë emër. Gjatësia mesatare e konservuar e mureve është rreth 160 m.

Në anën jugore ndodhet një kullë në formë trapezoidale, ndërsa në anën perëndimore një hyrje e përforcuar me kullë gjysmë rrethore. Brenda perimetrit të murit dallohen ndërtime shtëpish. Informacionet për kohën e ndërtimit janë sporadike, por mendohet që faza e parë e ndërtimit i përket shek. V para Krishtit dhe zë një sipërfaqe prej rreth 78 ha.

2.2 Fshati Nepravishtë

Njësia Administrative Libohovë

Vendndodhja

Nepravishta shtrihet mbi këmbët e malit të lartë të Buretos, përballë me fushën e gjerë të Drinos, Malin e Gjerë dhe Dropullin e Poshtëm në luginën e Drinos.

Para viteve '40 fshati Nepravishtë përbëhej nga dy mëhalla, mëhalla e sipërme së bashku me Kapsaqin dhe mëhalla e poshtme. Sot Nepravishta përbëhet prej pesë lagjeve. Lagjja e Sipërme, Kapsaqi, Lagjja e Poshtme, Lagjja e Kroit dhe Lagjja e Fushës.



Figura 57 Lagjet e fshatit Nepravishtë

Si rrjedhim Përbishtë do të thotë qendër e banuar, e shpërndarë në disa kilometra. Kështu është dhe Nepravishta, lagjet janë të shpërndara nga kodra në kodër e në gropishte.

Historia

Fshati mendohet se është ndërtuar në fillim të viteve 1700, fillimisht në lagjen e sipërme me banesa të mëdha 2, 3 dhe 4 katëshe të ngjashme me banesat karakteristike gjirokastrite. Rugët kryesore brenda fshatit kanë qenë të shtruara dikur me kalldrëm dhe janë gjetur gjatë gërmimeve gjurmë të një rrjeti kanalizimesh të ujrave të shiut me tubacione (qyngja) qeramike. Duke parë nivelin e ndërtimeve duket që ky fshat është ndërtuar nga njerëz të pasur kryesisht nga fise si Asllanatë, Çobanatë, Kullatë, Ymeratë, Minxhatë, Beqari etj.

Për emrin e Nepravishtës ka disa versione: i pari vjen nga sundimi sllav në Shqipëri në shekullin e X-të, ku thuhet se, ky emër mund të ketë prejardhje nga sllavishtja, se “Nepravo” do të thotë “Në krahë të djathtë” të rrjedhjes së lumit, gjë që i përgjigjet edhe shtrirjes gjeografike të fshatit, në krahë të djathtë të lumit Drino.

Versioni i dytë lidhet me leksikun e gjuhës tonë, ku ka një fjalë “Përbishtë” që do të thotë “Shpërndaj këtu-atje”. Si rrjedhojë “Përbishtë” mund të jetë një qendër e banuar e shpërndarë në disa kilometra nga kodra në kodër e Gropishtë, siç janë lagjet edhe sot. Grupet sllave të shekullit X mund të kenë transformuar këtë emër nga “Përbishtë” në “Nepërbishtë” apo Nepravishtë.

Ndërsa i treti është i pabazuar, me hamendje nga fjala “nepra” (spanjisht) që do të thotë fshat “rrëzë kodre” pasi në zonën tonë nuk ka patur dyndje spanjolle.

Përsa i përket prejardhjes së banorëve është i pranueshëm versioni, që ai të ketë origjinën nga banorët e hershëm të qytetit të Melanit, ku ishte vendosur qyteti i vjetër i fisit të Kaonëve që në periudha të ndryshme historike, siç përcaktojnë studiuesit, mori emrat Hadrinopol, Justinopol e Edrene dhe ky ka qenë jo një vendbanim i tyre i ri por një rikthim tek ish vendbanimet e para primitive, pranë ujit të shumtë të Vrizit. Ata janë vendosur në pjesën kodrinore të Lagjes së Sipërme dhe në gropishten e Lagjes së Poshtme dhe dalëngadalë kanë formuar fshatin me kufijtë e sotëm të shtrirjes së tij në afërsi të qytetit të lashtë.

Gjeografia

Nepravishta është një fshat i bukur me banesa të bukura, të rrethuara me pemë, lule dhe mure të larta. Ajo ndodhet 3.5 km në juglindje të qytetit të Libohovës i vendosur në këmbët e malit Bureto në lartësinë nga 300 deri 600 m mbi nivelin e detit, në territorin e qytetit antik Ilir të Melanit rreth 23 km larg qytetit të Gjirokastrës.



Figura 57 Lagja e poshtme, e parë nga teqeja e Melanit

Koordinatat gjeografike të vendndodhjes së fshatit janë në gjerësinë gjeografike 40° 00' 03" dhe gjatësinë gjeografike 20° 16' 04''.

Kufijtë

Fshati Nepravishtë kufizohet në veri nga bashkia Libohovë, në lindje nga mali Bureto, në pjesën jugore nga fshati Vllaho e fshati Goranxi dhe në perëndim me lumin Drino.

Popullsia

Në këtë fshat lëviz jeta e 763 banorëve të sotëm, jeta e tre brezave që bashkëjetojnë e punojnë.



Figura 58 Qendra e fshatit Nepravishtë

Ekonomia

Historikisht nepravishnjotët janë marrë me bujqësi dhe blegtori. Fshati ka shumë tokë bujqësore por nuk është e shfrytëzueshme sepse kanalet kulluese janë jashtë funksionit.

Nepravishnjotëve u pëlqen puna në vendlindje, bujqësia e blegtoria, ajo individuale e kolektive. Të paktë janë ata që ndjekin emigracionin ekonomik në të dy shtetet fqinj, Greqi dhe Itali. Të rinjtë preferojnë punësimin në vend si atë të "ALFA GLINA" në fshatin Glinë ku prodhohet uji mineral i Glinës dhe produkte të tjera të pijeve freskuese që tregëtohen në të gjithë Republikën. Një pjesë e popullatës e specializuar merret me punë ndërtuese objekteve si shtëpitë në fshat dhe më gjerë, deri në fshatrat e Dropullit të Poshtëm dhe të Sipërm. Të rejtat nga fshati punojnë në prodhim kartopeceta "Lineks" e "Alba" në Peshkëpi të Sipërme e në Dropull. Të rinjtë e tjerë punojnë në firma ndërtimi e në punë të tjera shtetërore.

Arsimi dhe Shëndetësia

Në fshat ka funksionuar që para vitit 1912 një shkollë fillore, metjep turk, që bënte pjesë në kompleksin e xhamisë në Lagjen e Sipërme dhe që ndiqej nga djemtë e fshatit. Deri në vitin 1920 në fshat dinin shkrim dhe këndim shqip mbi 20% e burrave si dhe një numër i vogël grash. Shkolla e parë shqipe hapet në 1919 nga mësuesi i parë i fshatit, Zija Nazim Spahiu, e cila qëndron e hapur deri në vitin 1932.

U rihap shkolla e ciklit fillor pas çlirimit të vendit në vitin 1945, e më vonë u bë shkollë e arsimit 7 - 8 vjeçar. Në qendër të lagjes së "Kroit", sot ngrihet me përmasa të dukshme që prej vitit 1980 shkolla 8-vjeçare e fshatit Nepravishtë e ashtuquajtur Ylbere Bylybashi, ku çdo vit ndjekin mësimet mbi njëqind nxënës nga Nepravishta dhe Drinua (fshati fqinj).



Figura 59 Shkolla 8 vjeçare "Ylbere Bylybashi"

Duke patur lidhje familjare me Libohovën shumë nepravishnjotë janë shkolluar në perandorinë turke dhe kanë punuar në pozicione të rëndësishme. Nepravishta ka nxjerrë intelektualë të shquar si jurist, gazetarë inxhinierë, arkitektë dhe doktorë.

Disa prej intelektualëve më të spikatur përmendim:

- Fuad Asllani, Ministër i jashtëm në vitet 1935-1937, një nga juristët e shkëlqyer shqiptarë të asaj kohe.
- Abedin Nepravishta, kryetar i Bashkisë së Tiranës në vitet 1932-39, intelektual i shquar.



Figura 60 Abedin Nepravishta

- Masar Asllani Nepravishta, në qeverinë e Ismail Qemalit ishte anëtar i Gjykatës së Lartë. Ishte një jurist i shquar dhe prokuror i Manastirit në 1908 ku dha një ndihmë të çmuar.

- Behxhet Nepravishta (Çobani), intelektual i shquar, prefekt i Beratit dhe Durrësit.
- Mexhit Asllani, jurist i njohur në qeverinë e Ismail Qemalit, inspektor i përgjithshëm i drejtësisë dhe në qeverinë e Sulejman Delvinës, Sekretar i Ministrisë së Drejtësisë.
- Suad Asllani, përfaqësuesi juridik në themelimin e bankës së Shqipërisë, jurist i njohur.
- Javer Çobani, inxhinier i talentuar, zëvendës Ministër Ndërtimi.
- Neim Çobani, inxhinier gjelog në fushën e sizmikës.
- Javer Çobani, kontriboi në ndërtimin e ujësjellësit në vitet 76-80.
- Agron Çobani, Drejtor i Përgjithshëm i Televizionit Shqiptar.
- Florian Nepravishta, Dekan i Fakultetit të Arkitekturës në ditët e sotme.

Në fshat janë në funksion dy qendra shëndetësore në të dy lagjet kryesore të fshatit si dhe dy infermierë në shërbim të komunitetit.

Ekonomia

Bujqësia

Prej vitit 1951 e deri në vitin 1990 nepravishnjotët u inkuadruan në kooperativën bujqësore vetjake dhe më vonë në atë të përbashkët në fshatrat e përreth dhe me Dropullin e Poshtëm. Në këto aktivitete nepravishnjotët u dalluan për blegtorë dhe bujq të mirë. Si sektor bujqësor i veçantë u dallua për rezultate të larta në kulturat bujqësore si: duhani, misri, pemtari e perime të verës. Më me emër nga këto kultura ka qenë dhe është duhani shumë i mirë i baçeve të Nepravishtës si dhe fiku i zi kokërrëmbël, me vija të bardha i po këtyre baçeve. Të dyja këto të kërkuara shumë në treg. I njohur është dhe ftoi kokërr madh i Nepravishtës, varietetin e të cilit agronomi i talentuar Abedin Çiçi nga Libohova, në kujtimet e tij, ia adreson xha Izetit (Çobani), një mullis, pemërritës i cili e kishte kultivuar vetë nga varietet e ftoit të Përmetit, Leskovikut e Delvinës prej vitit 1910 e këtej, në Nepravishtë. Një fakt të rëndësishëm e përmend studiuesi gjerman dhe albanologu z. Han gjatë udhëtimit në Shqipëri rreth viteve 1800, duhanin e Nepravishtës dhe Peshkëpisë. Ky duhan ka qenë i cilësisë së parë dhe pasi rihej në dersilat e Nepravishtës, dergohej dhe konsumohej në kabaretë e Francës (duhani quhej Burnot).

Në Nepravishtë ka patur shumë vreshta si në Kacarë dhe Revani ku nxirej raki dhe verë. Gjithashtu ka patur edhe shumë pemë me mana ku nxirej pekmezi.

Tre produkte të veçanta që Nepravishnjotët i kanë kultivuar janë duhani shumë i mirë i baçeve të Nepravishtës, fiku i zi kokërrëmbël me vija të bardha i po këtyre baçeve dhe ftoi kokërrmadh i Nepravishtës.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Llojet e pemëve që kultivohen në fshat janë ftoi, fiku, gështenja, dardha, shega, lajthia, bajamja, hardhitë dhe qershia.

Blegtoria

Në mbarështimin e krerëve numërohen 6000 krerë të imta dhe 300 krerë gjedhë në të gjithë fshatin.

Pyjet (Zona të mbrojtura)

Në hyrje të Nepravishtës objekti i parë, i bukur dhe më madhështor që shfaqet është kodra e Melanit e rrethuar me qiparize të lartë.

Si monumente kulture e natyre dhe atraksione turistike përmendim:

1. Kalaja e Melanit, monument kulture i kategorisë së parë
2. Teqeja e Melanit, monument kulture i kategorisë së parë
3. Burimi i Vrizit, monument natyre
4. Gështenja e Nepravishtës, monument natyre
5. Pylli me lisa i Nepravishtës (Ormani i Kapsaqit)
6. Portat me harqe shumë vjeçare të lagjeve të vjetra të fshatit



Figura 61 Pjesë muri nga Kalaja e Nepravishtës

Sipas inventarit të bashkisë në këtë fshat nuk ka zona të mbrojtura por aktualisht shtrihen mbi 100 ha pyje dhe rreth 259 ha kullota.

Rrjeti Rrugor

Rrugët kryesore brenda fshatit kanë qenë të shtruara dikur me kalldrëm dhe janë gjetur gjithashtu gjatë gërmimeve gjurmë të një rrjeti kanalizimesh të ujrave të shiut me tubacione (qyngja) qeramike. Rruga kryesore për në qendër të fshatit

është 4 km dhe ato rrugë që dikur ishin me kalldrëm, tashmë janë të betonizuara dhe të ngushta, drejt amortizimit.



Figura 62 Rrugët e fshatit Nepravishtë

Rrjeti Ujor

Në fshatin Nepravishtë ka disa burime ujore si Vrissi, Kroji, Burimet e Melanit, Burimi i Dashtës por edhe të tjera të cilat janë sezonale. Të gjitha shtëpitë e mëdha kanë qënë të pajisura me stera pasi burimet ujore gjendeshin në fund të fshatit. Sot një pjesë e fshatit, kryesisht ajo e lagjes së sipërme, furnizohen me ujë me pompa ndërsa lagjet më poshtë me sistem me vetërrjedhje. Nga burimi i famshëm i Vrisit ambalazhohet edhe uji në shishe “Spring”.

Uji i pijshëm

Ka burime të mjaftueshme ujore por rrjeti është tepër i amortizuar për furnizimin me ujë të pjesës më të madhe të fshatit. Mungesa e ujit të pijshëm ka qënë një problem i përhershëm i këtij fshati dhe vazhdon të mbetet e tillë.

Lumenj – Përrenj

Tokën e fshatit e përshkojnë Lumi i Drinos, Përroi Vrizit, Përroi i Handaqit dhe Përroi i Babos.

Rrjeti kullues

Kanale kulluese egzistojnë në fshat por momentalisht janë jashtë funksionit.

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Për banorët e fshatit Nepravishtë, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, në kuadër të reformës për tokën bujqësore janë ndarë 353 ha tokë nga 500 ha në total.

Besimi fetar

Në fshatin Nepravishtë ka patur dy xhami, ajo e Mëhallës së Sipërme dhe ajo e Mëhallës së Poshtme, Teqeja e Melanit dhe pesë tylbe. Besimi fetar është kryesisht bektashi dhe kjo lidhet edhe me teqenë e Melanit, e shpallur monument kulture së bashku me kalanë e Melanit dhe ujësjellësin e Melanit. Nga teqeja e Melanit vëzhgohet gjithë lugina e Drinos nga Kakavia dhe deri në Subash. Teqeja e Melanit është ndërtuar në fund të viteve 1600 dhe është unike në llojin e vet. Në Nepravishtë ka patur edhe shenja të vjetra të kishave si tek Gorica e Maros por edhe të Manastirit në vendin e quajtur Manastirraq.



Për origjinën Teqesë së Melanit, e këtij objekti të rrallë arkitekturik, kulturor e

fetar, ekzistojnë dy hipoteza: e para, që është një zgjatim i qytetit antik të Antigonesë dhe e dyta, që në territorin e saj ndodhen rrënojat e një qyteti tjetër të lashtë i panjohur deri në këto momente.

Figura 63 Teqeja e Melanit

E vendosur në këmbët e malit Bureto, ofron një peisazh të mrekullueshëm ashtu si edhe vetë arkitektura e saj. Madje edhe qiparisët që e rrethojnë janë mbjellë në mënyrë të tillë që nëse shihen nga lart, mund të lexosh fjalën allah. Gjurmët e qytetit të lashtë, mure rrethues e mjaft objekte të tjera që mendohet se i përkasin qytetit të lashtë ilir i shek. IV p.e.s. të paidentifikuar ende shtrihen në një sipërfaqe prej 34 hektarësh. Babai i Teqesë, Baba Skënderi, tregon se ai është një projekt i ardhur 600 vjet përpara nga Izmiri dhe u ndërtua nga vetë Baba Aliu më 1827.

Thuhet se ajo është e vendosur mbi pjesën e Akropolit të vjetër të qytetit të lashtë ilir. Në të njëjtin territor mendohet se gjatë periudhës historike të Bizantit ka ekzistuar një manastir i krishterë. Nga zaptimi prej uniformave ushtarake të sistemit monist, nga gradat, topat dhe bagëtisë e repartit, nuk bëri përjashtim as kjo Teqe nga më të njohurat në Ballkan nga 1967 deri më 1990. Kjo teqe ishte nga të parat që iu rikthyen besimtarët pas viteve 1990.

Për çdo ditë po sidomos për “ditë të xhuma”, ajo është dera e hapur e kalimtarit, e besimtarit dhe e kujt do që kërkon qetësinë dhe pastrimin e shpirtit, shërimin nën veprimin e fuqisë qiellore. “Është Teqe me famë në aspektin mistik” - thotë Baba Skënderi, duke treguar se 700-1000 vetë janë pak për dyert e Melanit në

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

ditë jo të zakonta. E veçanta e Melanit është e lidhur edhe me faktin se këtu kanë shërbyer disa nga “gjyshërit” më të nderuar bektashianë të zonës së Jugut, si Haxhi Ali Haqi Babai, Baba Qamili, Baba Selimi etj.

Ajo që e bën të veçantë është pozita strategjike ku ndodhet dhe fakti që banorët bektashianë të zonës, veçanërisht ata të komunitetit pereth e adhurojnë atë. Madje kanë qenë këta të fundit që me iniciativat e tyre personale dhe të ardhurat private, kanë bërë të mundur rikonstrukcionin dhe shndërrimin nga një stallë e dëmtuar para viteve 1990, në një objekt kulti të vizitueshëm.

3. BASHKIA TEPELENË

3.1 Fshati Nivicë

3.2 Fshati Peshtan

3.1 Fshati Nivicë

Njësia Administrative Kurvelesh

Vendndodhja

Fshati Nivicë shtrihet në një sipërfaqe prej 105 km² dhe është fshati me sipërfaqen më të madhe se çdo fshat tjetër i krahinës së Kurveleshit.



Figura 64 Pamje e fshatit Nivicë, e parë nga sateliti

Historia

Krahina e Kurveleshit shtrihet në perëndim midis Lumit të Shushicës dhe atij të Borshit, në veri dhe verilindje ka kufi lumin e Vjosës dhe në jug, Kardhiqin dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 700 km².

Sipas dokumenteve egzistuese kjo krahinë është organizuar si njësi më vete të emërtuar Kurvelesh, me 33 fshatra nga pushtuesit osmanë në fund të shek. të XVI-të (sipas regjistrit të vitit 1583). Megjithatë duhet theksuar se banorët e kësaj treve i rregullonin marrdhëniet e ndryshme shoqërore sipas të drejtës së tyre zakonore dhe jo ligjeve osmane, duke u vetëqeverisur pothuajse gjatë gjithë pushtimit osman.

Nga viti 1946 deri në vitin 1949 qendra administrative e Kurveleshit, në shkallë lokaliteti, kaloi në Kuç. Në vitin 1949, me organizimin e ri administrativ, Kurveleshi u shpërbë si njësi administrative, duke kaluar fshatrat në vartësi të rretheve Tepelenë, Gjirokastër dhe Vlorës.

Emri i hershëm i këtij fshati duke qënë se ishte i vetmi vend i banuar në këtë trevë brenda një kalaje, ka qënë “Fortesa”.

Prejardhja e emrit Nivicë mbështetet në dy teori, e para ajo e studjuesit italian Nicola Lupo, ku fjala Nivica nga “arkeologjia leksike” e ka prejardhjen nga fjala “Nevica” ku nga latinishtja në shqip përkthehet “Deborë”. Ushtria romake në vitet 167 para erës së re, një nga 70 kalatë (kështjellat) që ndërtoi e rindërtoi, ka qënë edhe ajo e Nivicës, duke e riemërtuar atë nga Fortesë në Fortesa e Nivicës, për ta dalluar nga kështjellat e tjera që në latinisht përkthehet Castlle Nevica ose Fortesa e Deborës. Me kalimin e kohës ky fshat u quajt shkurtimisht Nivica (Deborë) duke mos e përdorur më emërtimin e saj të plotë Fortesa e Nivicës.

Teoria e dytë është që vendi ku ndodhet ky fshat është vend malor (Kurveleshi i Sipërm) e në kohët e hershme debora në këto vise qëndronte deri në 8 muaj të vitit, duke u izoluar plotësisht për shumë muaj. Këto kushte klimaterike justifikojnë plotësisht emërtimin e saj si kështjella e deborës.

Fshati Nivicë është fshat mbi 2400 vjeçar dhe sipas Dr. Prof. Skënder Anamalit në studimin e tij nënvizon se lulëzimi i qytezës Ilire të Nivicës ka qënë në shekujt e III-I para erës së re, periudhë në të cilën në këtë trevë nuk ka patur vendbanim tjetër (Nivica është i vetmi fshat-kështjellë në Kurveleshin e Sipërm).

Pra prejardhja dhe metamorfoza e emërtimit të këtij fshati ka qënë:

Para pushtimit Romak: Fortese

Gjatë pushtimit Romak: Castella Nivica (Fortesa e Dëborës)

Pas pushtimit Romak: Nivica (dëborë)

Në vitin 1937: Fortesa

Pas vitit 1937: Nivica (Dëborë)

Kalaja e Nivicës: Kalaja antike i përket shekujve III-II p.e.s, rindërtuar në periudhën e perandorit Justinian dhe pushtimit Osman. Rrënojat e kalasë së Nivicës ndodhen majë një shkëmbi të thepisur, e pamundur t'i afroresh, në një kryqëzim strategjik rrugësh, rrethuar nga humnera, me thellësi 200-400 m. Nga tre anë ka një mbrojtje natyrale, ndërsa vetëm nga Perëndimi është e mbrojtur nga një mur guri me llaç gëlqereje, me gjerësi mbi një metër. Deri vonë është ruajtur një portë e brendshme me qemer, ndërtuar me gurë të latuar me gjatësi 0,5-1 metra, të nxjerra nga shkëmbinjtë e zonës. Në krahun lindor dallohet një udhë pothuajse shkallore që zbret në drejtim të lumit nëpërmjet një porte të çarë në shkëmb. Këto shkallare lidhin kalanë me lumin si dhe me dy mullinj që funksiononin nëpërmjet një vije uji që rridhte nga një e çarë në

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

shkëmb. Me sa duket, ky ishte edhe shtegu i furnizimit të kalasë në raste rrethimesh.

Gjeografia

Pika më e ulët e krahinës së Kurveleshit është në fshatin Nivicë (tek ura e Lumit) me 670 m kur lartësia mesatare e rrethit është rreth 730 m.

Kufijtë

Nivica kufizohet me 9 fshatra të rrethit të Tepelenës: Progonatin, Rexhinin, Gusmarin, Lekdushin, Bënçën, Salarinë, Dukaj, Veliqotin e Dhëmbëllanin dhe me një fshat të rrethit të Vlorës, Vërmik.



Figura 65 Kufijtë e fshatit Nivicë

Popullsia

Referuar regjistrit të perandorisë osmane të vitit 143, të botuar në Ankara në vitin 1954 nga Halil Inalcik, Nivica figuronte me 40 hane, numër relativisht i madh ky duke e krahasuar me fshatrat e tjerë të zonës. Ndërsa në regjistrat e viteve 1581 – 1583 ky fshat rezulton të kishte 90 familje. Sipas të dhënave pas viteve 1600 kjo qytezë ka patur mbi 350 shtëpi ku mbizotëronin ndërtesat dykatëshe, kati i parë përdorej për rezerva ushqimore dhe kati i dytë për banesë familjare.

Kjo qytezë ndahej në dy lagje të mëdha:

- *Lagja Petoshaj* e cila përbëhej nga katër mëhalla, Gaxhaj, Xhoxhaj, Skendaj dhe Trushaj
- *Lagja Gërxaqaj* e cila përbëhej nga 3 mëhalla, Semilaj, Nikecaj dhe Strataj

Lagja Petoshaj ishte lagja më e madhe përbëhej nga mbi 59 fise kurse lagja Gërxaqaj nga mbi 21 fise.

Para viteve 1913-1914 ky fshat kishte rreth 325 shtëpi me një popullsi prej 1450 banorë. Por më vonë si rezultat i luftës italo-greke ku ushtria greke në vitin 1914 dogji gjithë fshatin duke detyruar shumë familje të shpërnguleshin përgjithmonë nga vendlindja e tyre. Në regjistrimet e vitit 1923 në këtë fshat banonin vetëm 150 familje me 1025 banorë.

Shpërngulje në masë më të gjerë pati pas vitit 1991 si rezultat i lëvizjes së lirë të popullsisë ku shumë nga familjet u shpërngulen në rrethe të tjera të vendit por edhe jashtë Shqipërisë. Aktualisht në Nivicë banojnë rreth 40-50 familje me rreth 150-200 banorë.

Arsimi dhe Shëndetësia

Shkolla e parë shqipe e krahinës së Kurveleshit e cila u hap në Nivicë në vitin 1909, shkolla e parë shqipe për gjithë krahinën e Kurveleshit dhe e dyta e hapur në rrethin e Tepelenës. Në vitin 1956 shkolla fillore e këtij fshati u bë shkollë 7-vjeçare dhe më vonë u ngrit shkolla e mesme. Por përgjatë historisë, për faktorë të ditur si largimi i popullsisë, rënia ekonomike dhe nga degradimi i infrastrukturës, aktualisht funksionon vetëm një shkollë e arsimit 9-vjeçar.

Në vitin 1949 është hapur ambulanca e parë mjekësore por aktualisht nuk është më në funksion.

Ekonomia

Si për të gjithë banorët e kësaj krahine, ashtu edhe për ata të Nivicës, duke u nisur nga territori ku jetojnë si dhe kushtet natyrore të zonës, baza kryesore e ekonomisë për çdo familje ka qënë dhe ngelet blegtoria.

Bujqësia

Kjo zonë cilësohet e pasur nga ana agrikulturore ku shtrihen rreth 627 ha tokë e përdorur bujqësore, 366 ha tokë bujqësore e lirë, 2780.4 ha pyje, 6162 ha kullota, 176 ha arrë. Toka bujqësore zë vetëm rreth 7 % të gjithë sipërfaqes.

Flora në përgjithësi e ndihmuar edhe nga kushtet klimaterike, është shumë e pasur. Në kodrat e malet e këtij fshati gjen shumë bimë aromatike ku veçojmë cajn e malit, salepin, trëndelinën e shumë bimë të tjera të kësaj familje të cilat krijojnë mundësi për kultivimin e prodhimin jo vetëm të bimëve aromatike por edhe të atyre mjekësore.

Pemëtaria

Një nga vendet me mikroklimë shumë të veçantë në të gjithë krahinën është “Stoku” i cili ndodhet në lindje të këtij fshati. Në këtë vend ku klima është më e

buta e zonës, janë të gjitha mundësitë për ngritjen e plantacioneve me pemë frutore e sidomos me mollë. Në fshat ka disa punishte të vogla familjare për përpunimin e rrushit. Në zonat më të larta rritet pisha e bredhi ndërsa në zonat më ulëta kultivohet molla, ftoi, qershia, arra, gorrica, fiku, lajthia etj. Gjithsej gjenden rreth 21 ha pemtore.

Blegtoria

Pjesën më të madhe e zënë tufat me bagëti të imta si delja dhe dhia, duke bere emër me nënproduktet e qumështit si djathi, gjalpi, salca e kosit etj. Në strukturën e blegtorisë, të imtat zënë peshën kryesore të numrit total të saj me rreth 97%, nga të cilat 84.7% të leshtat dhe 12.8 % të dhirtat. Numërohen gjedhë 250, lopë 38, dhen 4000, dhi 700, shpendë 1600, njëthundrakë 90 dhe bletë 620. Si lloje të rralla kafshësh e shpendësh janë kaprolli, derri i egër, pëllumbi i egër e sidomos thëllëza e malit.

Numri i blegtorisë egzistuese e krahasuar me kapacitetin kullosor të këtij fshati tregon se mundësitë e ritjes numerike të saj janë shumë herë më të mëdha që do të bëjnë të mundur që krahas shitjes së freskët të qumështit e nënprodukteve të tij, edhe ngritjen e industrisë ushqimore për të rritur gamën e prodhimeve më të kërkuara në treg.



Kullota

Kullotat zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes totale të fshatit me rreth 70%, gjithësej rreth 2238 ha kullota.

Figura 66 Sipërfaqet kullosore në fshatin Nivicë

Rrjeti Rrugor

Në vitin 1945 – 1946 filloi puna për ndërtimin e rrugës automobilistike Tepelenë – Salari -Nivicë - Progonat, e ndërprerë për më shumë se një dekadë dhe për të filluar përsëri punimet në vitin 1959.

Në vitet 1970 - 1980 u hap rruga e re automobilistike që lidhte këtë krahinë me qytetin e Tepelenës nga fshati i Bënçës, duke bërë të mundur që Nivica nga qendra e rrethit të jetë vetëm 31 km larg.

Rrjeti Ujor

Uji i pijshëm

Në vitet 1986-1987 u ndërtua ujësjellësi i ri duke marrë ujin e ftohtë të Vrutkës me vetërrjedhje, duke garantuar kështu ujin e pijshëm 24 orë në ditë në këtë fshat. Në Vrutkë ka dhe një burim me ujë të bollshëm e shumë i ftohtë që vjen nga mali i Këndrevicës nga i cili furnizohet sot ky fshat me rrjedhje të lirë për 24 orë.

Liqene (Ujëmbledhës)

Në vitin 1969 filloi ndërtimi i rezervuarit me një kapacitet 200.000 m³. Ky rezervuar grumbullon ujrën e burimeve të “Llufë” si dhe gjithë burimet përreth duke shërbyer për vaditjen e 150 ha tokë bujqësore. Krahës këtij qëllimi, ky rezervuar ndihmon shumë sidomos në stinën e verës dhe për blegtorinë që kullosin në zonat përreth. Dëmtimet që pësoi ky rezervuar gjatë periudhës së tranzicionit i ka nxjerrë jashtë funksionit si veprat e marrjes ashtu edhe kanalizimet e shpërndarjes së ujit për vaditje.

Lumenj – Përrenj

Në shtrirjen gjeografike të fshatit, konfiguracionit të terrenit, i cili përveç lumit përshkohet edhe nga përrenj të tjerë, për lidhjet midis vendbanimeve janë ndërtuar disa ura të hershme harkore me qemer guri. Nga katër ura të tilla, nga të cilat dy mbi lumin e fshatit dhe dy mbi përrenjtë e tjerë, sot funksionojnë tre prej tyre, ura e Çorovodës, Mullirit dhe ajo e Lumit.



Figura 67 Ura e Çorovodës



Figura 68 Ura e Mullirit

Në mes të këtij fshati kalon një perrua që banorët e kanë quajtur që në kohë të hershme “lumi i Nivicës” për ta dalluar nga përrenjtë e tjerë që mbledh gjatë shtratit të tij prej 12 km deri në bashkimin me lumin e Bënçës. Burimin ky lum e ka nga “Llufa” dhe në pjesën e poshtme të tij ka një pamje mahnitëse me humnera të thepisura dhe me një shtrat shumë të ngushtë duke krijuar kanione përrallore dhe në bashkimin me lumenjtë e tjerë krijojnë ujvara shumë të bukura

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

e të veçanta. Kështu mund të përmendim ujvarën që krijon përroi i Çorovodës, ujvarën me dy kate të Kastravicës, ujvarën e përroit të Pesjakut etj.



Figura 69 Ujëvara e Guvës (Pellgu i Zi)



Figura 70 Kanionet e Nivicës



Figura 71 Kanionet pas Urës së Madhe

Në një lartësi prej 700 - 750 m në nivelin e shtrirjes së fshatit, ky lum ka krijuar ndër shekuj kanione unike, guva uji dhe pellgje të formuara nga gërryerjet që u janë bërë formacioneve gëlqerore si pellgu i Bylyshe, pellgu i Gjatë, pellgu i Hademit etj.

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Për banorët e fshatit Nivicë, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “*Për tokën*”, në kuadër të reformës për tokën bujqësore janë për tu ndarë 197 ha dhe janë shpërndarë gjithsej 94 ha tokë bujqësore.

Besimi fetar



Para sundimit turk, besimi fetar, ashtu si në gjithë krahinën e Kurveleshit të Sipërm, edhe për këtë fshat ka qënë ai i krishterë.

Figura 72 Ish-xhamia e fshatit Nivicë

Sipas një dokumenti turk të vitit 1789, në ndarjen tokësoro-administrative të Turqisë, krahina e Kurveleshit formonte një unitet me krahinën e Himarës e cila e ruajti deri në fund fenë e krishterë. Ndikimi i fesë myslimane në këtë krahinë ka qënë relativisht i ulët megjithatë i detyrueshëm. Pas ndërrimit të fesë në atë myslimane (sekti Bektashian) në këtë fshat u prishën kishat dhe në mes të fshatit u ndërtua një xhami, nga e cila ka prejardhjen edhe sheshi i fshatit. Por sot nga kjo xhami kanë ngelur shumë pak gjurmë.

Kisha: Kisha e Vrutkës, Kisha e Drimoit, Kisha e Kuke
Xhami: Xhamia në qendër
Teqe: Mekami i Shehe, mekami te maja e Seferit

Kultura dhe Turizmi

Në vitin 1978 në Nivicë të Kurveleshit nga nëntoka, në vendin e quajtur Plodë, doli një figurë e vogël bronxi, siç e cilëson në vitin 1984 arkeologu i ndjerë Skënder Anamali. Statueta rreth 8 cm e gjatë përfaqëson një mashkull lakuriq, me një mjekër të gjatë dhe pozicion kërcënues. Vrima në dorën e djathtë të bën të kuptosh se në të ka qënë i vendosur një tjetër objekt, i cili me shumë gjasa lidhet me figurën e Zeusit rrufehedhës. Të dhënat tregojnë se kjo figurë është gdhendur diku në punishtet e Amantias, qytetit të lashtë i cili ngrihet sot në afërsi të fshatit Ploçë të Vlorës. Sa i takon datimit ai mendohet se lidhet me shekujt III – I para erës sonë e me shumë gjasa tregon lulëzimin në atë periudhë të qytezës ilire në Nivicë të Kurveleshit.

Shqiponja në bronx është ndër zbulimet e tjera të bëra gjatë gërmimeve arkeologjike në Nivicë të Kurveleshit. Ky objektet e ka lartësinë 8 cm, gjerësinë e krahëve të hapura 10 cm dhe peshon afërsisht 250 gr.

Eshtrat e Niviciotëve dëshmorë të atdheut prehen përjetë në varrezat e dëshmorëve të Kurveleshit të Sipërm të ndërtuar në një kodër pranë fshatit Progonat, e cila shikohet nga të gjitha fshatrat e tjerë si monument i përjetshëm i historisë së kësaj krahine patriotike e atdhedashëse. Obelisku i këtyre varrezave është i mbështetur në pesë kolona të cilat përfaqësojnë në mënyrë figurative unitetin e pathyeshëm të pesë fshatrave që përbëjnë krahinën e Kurveleshit.



Figura 73 Zeusi rrufehedhës

Burimet natyrore në këtë fshat plotësojnë të gjitha kushtet e zhvillimit të turizmit të gjelbër si zhvillimi i turizmit alpin, turizmit lumor alpin dhe turizmit eksplorues. Pozicioni gjeografik e kushtet natyrore të fshatit lejojnë zhvillimin e turizmit në të gjitha format e tij, ditor, disa ditor ose stacionar. Krahës lëvizjes me automjete të larta, për vetë infrastrukturën egzistuese, më e favorshme është “turizmi aventurë”, ai i lëvizjes me kuaj ku vizitori ka më shumë mundësi të eksploroj zona të ndryshme.

3.2 Fshati Peshtan

Njësia Administrative Qendër Tepelenë

Vendndodhja

Fshati Peshtan është pika hyrëse për në Luginën e Zagories nga rrjedha e poshtme e lumit. Ai shtrihet rreth 16 km larg në lindje të qytetit të Tepelenës, në bregun e majtë të lumit Vjosa, aty ku bashkohet Lumi i Zagories me Vjosën. Peshtani gjendet në qendër të një prej grykave më të mëdha në Ballkan, Gryka e Këlcyrës me gjatësi rreth 13 km, një monument i rrallë natyror. Fshati Peshtan shtrihet në Veri - Lindje të Njesisë Administrative Qendër Tepelenë në një sipërfaqe prej 26 km².



Figura 74 Pamje e fshatit Peshtan nga sateliti

Historia

Fshati Peshtan ka një histori të larmishme me natyrën, betejat dhe përplasjet historike, por edhe me monumentet e rëndësishme fetare. Në kohëra të ndryshme territori rreth Peshtanit ka qenë një arenë e përgjakshme luftrash dhe betejash për pushtet. Ka shumë histori që lidhen me këtë zonë. Ky është një vend nga ku kanë kaluar trupat romake, normanët, osmanët, dhe është prekur nga Lufta e Parë Botërore dhe Lufta e Dytë Botërore. Në një bujtinë në Peshtan gjen një muze të luftës së Dytë Botërore me të gjitha armatimet dhe pajimet e betejës Italo-Greke dhe për vizitorët e largët australiane kjo është një histori që i befason. Atraksionet e zonës janë të shumta. Burime me ujë të kristaltë rrjedhin nëpër kanione dhe gryka duke përvijuar peizazhin. Ura të vogla prej guri të

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

epokës osmane, të paprekura prej shekujsh, ende kalojnë sipër kanaleve. Peisazhi është i mrekullueshëm dhe natyra gjithashtu është e paprekur.

Kufijtë

Fshati Peshtan kufizohet në veri me fshatin Mezhgoran, në lindje nga Kalaja e fshatit të Malëshovës, në perëndim nga fshati Kodër dhe në jug me malin e Çajupit.

Popullsia

Aktualisht në këtë fshat numërohen rreth 250 banorë.

Arsimi

Fëmijët e këtij fshati shkollohen në shkollën 9- vjeçare të fshatit që njihet me emrin "Llukan Xhagjika".

Ekonomia

Ekonomia e këtij fshati është e lidhur me pyjet, bujqësinë dhe blegtorinë. Banorët e kësaj zone kanë qenë dhe janë specialistë të mirë për drurin dhe jo vetëm për nevojat e tyre, por edhe për tregti. Me lëndën e parë të drurit që pritët në Peshtan janë ndërtuar fshatrat e Këlcyrës dhe të Tepelenës. Aty është edhe vendi i bletërritësve. Si pyjet edhe bletët u kanë sjellë banorëve të ardhura të mëdha. Aktualisht e ardhmja e fshatit mbetet turizmi malor. Në fshat ka rreth 50 shtëpi në gjendje aktive dhe po shtohen për shkak të ngritjes së infrastrukturës, urës mbi Vjosë dhe rrugës së asfaltuar. Përsa i përket blegtorisë, në këtë zonë numërohen rreth 1000 kokë të imëta, 150 gjedh dhe 15 njëthundrak.

Bujqësia: Kryesisht bujqësia është e përqëndruar në kulturën foragjere për blegtori dhe në konsumin familjar sipas stinës me mbjelljen e zarzavateve të ndryshme. Mbizotërojnë vreshtat dhe ullinjtë por nuk ka asnjë punishte për përpunimin e tyre.



Figura 75 Kullotat në fshatin Peshtan

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Blegtoria: Numërohen rreth 1000 kokë të imëta, 150 gjedh dhe 15 njëthundrak. Nuk ka asnjë punishte për përpunimin e bulmetit.

Pyjet: Në fshatin Peshtan shtrihen rreth 1500 ha pyje zonë e mbrojtur.

Rrjeti Rrugor

Gjatësia nga rruga kryesore është 2,8 km e shtruar me asfalt ndërsa nëpër fshat e kalueshme me vështirësi.



Figura 76 Pamje nga fshati Peshtan

Rrjeti Ujor

Uji i pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm është zgjidhur nga vetë banorët me rrjedhje të lirë.

Lumenj, Përrenj

Kjo zonë përshkohet nga lumi Vjosa në veri dhe nga lumi Zagorie në lindje, ndërsa fshatin e përshkon Përroi i fshatit dhe Përroi i Keq.

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Për banorët e fshatit Peshtan, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “*Për tokën*”, në kuadër të reformës për tokën bujqësore janë për tu ndarë 85 ha tokë dhe janë shpërndarë gjithsej 63 ha tokë bujqësore.

Besimi fetar

Fshati i përket zonës etnografike të Zagories dhe është fshat me përbërje ortodokse dhe bektashi, një sekt i moderuar myslyman që përbën shumicën e myslimanëve të Shqipërisë. Në rrënjën e vet fshati ka pasur 170 familje nga të

cilat rreth 100 ortodokse dhe pjesa tjetër betkashinj, që mendohet se janë konvertuar si të tillë në periudhën e Ali Pashë Tepelenës. Fshati ka pesë objekte fetare të vjetra tashmë të rrënura që janë dhe kishat më të vjetra në jug të Shqipërisë:

- Kishën e Shën Thanasit
- Kishën e Shën Kollit
- Kishën e Shën Mërisë
- Kishën e Shën Konstandinit
- Kishën e Shën e Premtes



Figura 77 Kisha e rikonstruktuar e Shën Marisë

Kisha e Shën Kollit është më e vjetra. Ajo gjendet në rrugën nga Peshtani drejt fshatit Kala, rreth 3 km në lindje të fshatit. Kisha është e ndërtuar fillimisht në vitin 1112. Fshati nuk ka asnjë objekt fetar të fesë bektashiane. Në tërësi pjesa bektashiane e fshatit ka ndjekur festat dhe ritet ortodokse.

Kultura dhe Turizmi

Fshati ka pasur një traditë të fortë kulturore. Një nga poetët disident të komunizmit i cili u pushkatua për shkak të krijimtarisë së tij është Trifon Xhagjika, i lindur në Peshtan, nga familja e njohur Xhagjika. Ndërkohë një prej aktorëve më të mëdhenj të Teatrit Kombëtar shqiptar Viktor Gjoka është nga Peshtani. Ai vdiq në vitin 2007 në Romë. Nga ky fshat ka dhe shumë personalitet të njohura në fushën e diplomacisë, politikës, gazetarisë dhe jetës publike në Shqipëri. Aktualisht në fshat është në traditë grupi polifonik i fshatit me këngë popullore.



Figura 78 Këmbana e rigjetur e Kishës së Shën Mërisë



Figura 79 Artifakte të gjetura

Fshati Peshtan ka një prespektivë të mirë sa i përket përdorimit të Vjosës për turizëm. Duke qenë se Vjosa në Peshtan është në një nga pjesët e saj më të bukura, aty ka filluar zhvillohet sporti i kanotazhit dhe për çdo vit shtohen grupet e turistëve që frekuentojnë fshatin për këtë lloj turizmi. Gryka është po ashtu e dobishme për turizmin e speliologëve. Grupe eksploruesish janë shpesh vizitorë të shpellave në zonë. Shpellat gjenden në shumicë në rrëzën e Malit Trebeshinë dhe Shëndëlli, përballë Peshtanit por dhe buzë Vjosës në Malin e Golikut dhe Dhëmbelit. Vetëm 5 kilometër nga Peshtani, mbi shpatin e malit Dhëmbel, gjendet shpella e Petranikut me një thellësi 300 metra.



Figura 80 Ura e Bathishtës



Figura 81 Ura e Peshtanit

Sporti më i pëlqyer nga turistët është ngjitja në mal. Nga Peshtani egziston një shteg malor që përshkruhet me kal nga turistët i cili të fut në Luginën e Zagories dhe del në Malin e Çajupit. Rruga përshkruan një territor prej 20 km plot me pyje lisi, bredhi, blini dhe ujëra pa fund, në një zonë tërësisht të virgjër. Një tjetër shteg malor është ngjitja nga Peshtani, në Majën e Malit të Golikut, një

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

mal tërësisht i veshur me pyll të lart. Ngjitja në lartësinë rreth 200 metra të kushton rreth 4 orë në ngjitje dhe 3 orë në zbritje.



Figura 82 Lëmi i Thanës

Dy km në lindje të fshatit në rrugën e vjetër Peshtan Limar, gjendet *Kanioni i Urës së Bathishtës*, mbi lumin e Zagories, ku dy brigjet afrohen rreth 20 metra me njëri tjetrin. Kanioni është i vizitueshëm dhe shërben dhe si një pellg për not nga turistët. Poshtë fshatit buzë Vjosës, rreth 1 km nga qendra, gjendet *plazhi i Gurrave*, një vend ku banorët e fshatit e përdorin tradicionalisht për pushime verore dhe plazh. Aty ka burime natyrore uji të pijshëm, rërë të mirë dhe hije të rrapinjve të vjetër. Pranë kalon dhe kanali i vjetër ujitës i fushës së Peshtanit.

4. BASHKIA MEMALIAJ

4.1 Fshati Kalivaç

4.1 Fshati Kalivaç

Njësia Administrative Krahës

Vendndodhja

Fshati Kalivaç gjendet mbi disa kodra e bregore, në Njësinë Administrative Krahës të rrethit Tepelenë dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 548 ha.



Figura 83 Pamje e fshatit Kalivaç nga sateliti

Historia

Kalivaçi i Tepelenës është një fshat i lashtë e me histori. Sipas një vështrimi arkeologjik, në lashtësi dëshmohet se në Kalivaç të Tepelenës ka patur ngulime edhe më të hershme të cilat datojnë shekujt e parë, para Erës së Re. Kalaja e lashtë në mëhallën e Hasanbagajve, si dhe vendi i quajtur Qytet, po në këtë mëhallë, na sjellin dëshmi të pakundërshtueshme për lashtësinë e kësaj treve. Në kohët moderne, Kalivaçi i Tepelenës u bë një nga fshatrat më të mëdhenj të krahinës e të rrethit, duke luajtur një rol jo të pakët në jetën dhe veprimtaritë e kësaj treve të rëndësishme të Jugut të Shqipërisë. Mëhallët që bëjnë fshatin e Kalivaçit të Tepelenës, të paktën prej 100 vjetësh nuk kanë ndryshuar.



Figura 84 Pamje e fshatit Kalivaç



Figura 85 Pamje nga lartësia e fshatit Kalivaç

Gjeografia

Fshati Kalivaç shtrihet në perëndim të Qendrës Administrative Krahës në Lindje të lumit Vjosë në lartësinë 280 m mbi nivelin e detit.

Kufijtë

Ky fshat kufizohet në veri me fshatin Çorrush, në jug me fshatin Anëvjosë, në lindje me fshatin Përparim dhe në perëndim me lumin Vjosë dhe fshatin Shkozë.

Popullsia

Popullsia e Kalivaçit është autoktone. Luhatjet e kohës dhe proceset demografike të zhvendosjes së popullsisë të cilat kanë përfshirë edhe këtë fshat, nuk ia kanë dalë të tjetërsojnë e zhbëjnë autoktoninë e banorëve të Kalivaçit. Mëhallët janë ndërtuar e funksionojnë mbi bazë fisi. Ky detaj e ka bërë të qëndrueshme e të pandryshueshëm raportin me autoktoninë. Në fshatin Kalivaç të Tepelenës, historikisht nuk ka pasur popullsi të përzier. Në disa raste, banorë nga fshatrat fqinjë, me pëlqimin e vendasve janë ngulur në trojet e të afërmeve të tyre në Kalivaç të Tepelenës. Aktualisht në fshat banojnë rreth 520 banorë.

Ekonomia

Bujqësia: Fshati Kalivaç ka pozicion gjeografik të favorshëm dhe klimë të përshtatshme për rritjen e pemëve frutore të ndryshme. Vendin kryesor e zë kultura e ullirit. Duke u ndodhur nën ndikimin e lumit Vjosë, në Kalivaç vegjetojnë shkurre masive me drurë koçimare; përralle, xina, paliçe, mërete, konopice etj. Arrat e begata, në veçanti ato në Rredhe, Margëllic,

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Muratova, Vidhishte, Jorga, Llagëme, Fusha e Leshnjës etj, me prodhimtarinë e tyre, ku vendin e parë e zë misri, e kanë mbajtur gjallë jetën e fshatarëve. Fshati Kalivaç ka tokë bujqësore rreth 527 ha, pyje dhe shkurre 200 ha ndërsa kullota e livadhe rreth 500 ha, 13 ha pemëtari dhe 30 ha ullishte.



Figura 86 Lisi i Hysajve

Blegtoria: Në Kalivaç ka kullota të lakmuara për rreth 2000 krerë dhi e për rreth 800 krerë dhen. Banorët e këtij fshati kanë qenë e janë mbarështues cilësorë të bagëtive të imëta.

Guri i Kalivaçit, me përbërje gëlqerore, lehtësisht i punueshëm dhe i bukur, është një pasuri e madhe e fshatit. Këto pasuri e të tjera vlera natyrore janë transformuar në të mira materiale për banorët.

Arsimi dhe Shëndetësia

Në fshatin Kalivaç ndodhet shkolla 9-vjeçare “Sami Musaj”, e ndërtuar në vitet 30 të shekullit të XX të. Është ndërtuar me konstruksion guri të bardhë dhe kryen funksionin e saj dhe në ditët e sotme. Mësuesit e kësaj shkolle, në vitet e parë të ekzistencës së saj ishin të ardhur nga rrethet e tjerë të vendit; kryesisht



Figura 87 Shkolla e fshatit "Sami Musaj"

nga Elbasani e Gjirokastra, për arsye të njohura. Sot, në shkollën e Kalivaçit japin mësim vetëm arsimtarë vendas. Nderi dhe merita si mësues i parë i kësaj shkolle i takon kalivaçasit Halil Zoto Ramaj. Përsa i përket shërbimit shëndetësor në fshat funksionon dhe një qendër shëndetësore me personel infermier.

Rrjeti Rrugor

Për gjendjen e rrugëve që të çojnë në fshat, 7 km nga qendra administrative është e mirë me asfalt ndërsa brenda fshatit qarkullimi bëhet me vështirësi.

Rrjeti Ujor

Uji i pijshëm

Në fshat është i ndërtuar një ujësjellës, me një depo uji, në gjëndje të mirë dhe në funksionon të përditshëm.



Figura 88 Pus uji familjar

Liqene

Ujëmbledhësi i Kalivaçit ka një sipërfaqe prej 3000 m² por nuk përdoret për vaditje pasi është dalja e ujit është e bllokuar.

Lumenj –Përrenj

Këto zona i përshkon lumi Vjosa nga perëndimi dhe Përroi i Velidonit.

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Për banorët e fshatit Kalivaç, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, në kuadër të reformës për tokën bujqësore janë për tu ndarë 275 ha tokë dhe janë shpërndarë gjithsej 220 ha tokë bujqësore.

Besimi fetar

Banorët e Kalivaçit të Tepelenës, përgjithësisht janë paganë. Ndikimi i pushtimit të gjatë osman, në përpjekje për të realizuar shkombëtarizimin e popullsisë shqiptare i kanë rreshtuar banorët e kalivaçit të Tepelenës në sektin Bektashian, të fesë Myslimane. Duke gjykuar nga ritet, në raste e ngjarje të ndryshme, mund të thuhet se në Kalivaç komuniteti, përgjithësisht ndjek ritet pagane. Disa toponime e zbulime arkeologjike dëshmojnë se treva e Kalivaçit të Tepelenës dhe popullsia e saj kanë qenë të krishterë.

Në vendin ku është ndërtuar mëhalla Ruç, edhe sot janë të dukshme rrënojat e një kishe ortodokse Mesjetare. Thuhet se një kishë e madhe e me ndikim të fuqishëm në jetën shpirtërore të fshatarëve të Kalivaçit ka qenë e ndërtuar në vendin e quajtur Vështi i Beres, ndërmjet fshatit Zhulaj dhe Kalivaçit, pranë Majës së Marucës.

Kultura dhe Turizmi

Kalaja e Kalivaçit: Në rrethin e Tepelenës daton nga shek. V Para Krishtit, është monument kulture që shtrihet në pjesën jugore të fshatit me të njëjtin emër. Me vendndodhje mbi një kodër shkëmbore, kalaja e Kalivaçit e listuar në objektet monument kulture para viteve '90.

Në fshatin Kalivaç ndodhet edhe *gura* një mrekulli natyrore e ruajtur brez pas brezi.

Kënga labe: Në fshatin Kalivaç është kënduar në festa familjare dhe kombëtare dhe ka hijeshuar skenat e vendit e të botës. Në vitin 1965, këndoi për herë të parë në festivalin folklorik të zonës grupi polifonik i Kalivaçit të Tepelenës, i kryesuar nga Skënder Muharrem Nelaj i cili themeloi grupin polifonik të fshatit, e më pas u trashëgua brez pas brezi deri në ditët e sotme.

4. BASHKIA PËRMET

5.1 Fshati Leusë

5.2 Fshati Kosinë

5.1 Fshati Leusë

Njësia Administrative Petran

Vendndodhja

Fshati Leusë gjendet në pjesën jugore të qytetit të Përmetit 2 km larg tij rrëzë malit të Dhëmbelit, me gjatësi gjeografike 20°21'24.95" L dhe gjerësi gjeografike 40°13'07.81" V. Lartësia mbi nivelin e detit është 411 m. Shtrihet në një sipërfaqe prej 85.000 m²



Figura 89 Pamje e fshatit Leusë nga sateliti

Historia

Fshati Leusë është një vend turistik ku mund të vizitohet Kisha “Shën Maria” e ndërtuar në shek. XVII me afreske dhe ikonostas mahnitëse të cilat u kanë rezistuar kohërave. Kjo kishë vizitohet çdo vit nga mbi 3000 turistë. Po kështu është një vend piktoresk ku ndërthuren elementet gjeografike me relievin konfigurativ ku organizohen guida turistike dhe shërben si pikë lidhëse me krahinën e Zagories.



Figura 90 Pamje e fshatit Leusë

Gjeografia

Përgjithësisht karakterizohet nga një reliev kodrinoro-malor. Kodrat kanë një lartësi 600-700 m në drejtimin jug-perëndim. Në jug-lindje të fshatit ndodhet Qafa e Dhëmbelit me lartësi 1464 m dhe me majën më të lartë, Mali i Dhëmbelit 2080 m.

Kufijtë

Fshati Leusa kufizohet në veri me qytetin e Përmetit, në jug me shpatin e malit të Dhëmbelit, në lindje me fshatin Leshicë dhe në perëndim me fshatin Lipe.

Popullsia

Ky fshat ka një popullsi prej 111 banorësh dhe numri i familjeve shkon në 37.

Ekonomia

Fshati paraqet një vend ekonomik miks në sektorët si bujqësia, blegtoria, bletaria dhe turizmi që po merr gjithnjë e më tepër zhvillim në vitet e fundit.

Bujqësia: Karakterizohet nga ferma shumë të vogla bujqësore, familjare të cilat nuk arrijnë rendimente të larta. Fermerët e këtij fshati merren me kultivimin e pemëve frutore, rrushit në pjergulla dhe perimeve tradicionale.

Pemëtaria: Kultivohen përgjithësisht qershia, kumbulla dhe arra. Në fshat numërohen gjithësej pemë të shpërndara 240 dhe pjergulla 280. Përpunimi i tyre bëhet në mënyrë artizanale mbi baza familjare ku prodhohen rakia, vera, llojet e glikove e reçelrave apo dhe perimet e thata sipas traditës.

Blegtoria: Është ndër burimet kryesore për të krijuar të ardhurat ekonomike të familjeve. Këtu mbarshtohen të imta dhe gjedhe. Numri i tyre arrin në 345 të dhirta, 135 të leshta dhe 20 gjedhe. Nuk ka punishte të përpunimit të bulmetit si baxho. Qumështi përpunohet individualisht nëpër familje.

Pyjet: Fshati Leusë rrethohet nga një sipërfaqe pyjesh prej 129 ha. Bimësia është kryesisht mesdhetare dhe përfaqësohet nga shkurret, dushqet dhe haloret.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Kullotat: Në këtë fshat ka një sipërfaqe prej 72 ha me kullota që shërbejnë për mbarështimin e blegtorisë të cilat ndodhen në pjesën jug-perëndimore të fshatit.

Arsimi dhe Shëndetësia

Në këtë fshat ka vetëm një shkollë të ciklit të ulët dhe funksionon një qendër ambulante për shërbimin shëndetësor.

Rrjeti Rrugor



Fshati Leusë lidhet me qytetin e Përmetit nëpërmjet një rruge automobilistike me gjatësi 1.5 km e pa asfaltuar (rurale). Në brëndësi të fshatit ka rrugë të shtruara me gurë (kalldrëm) dhe janë në gjendje jo të mirë, duke patur nevojë për rikonstruksion.

Figura 91 Rrugët në fshatin Leusë

Rrjeti Ujor

Uji i pijshëm

Fshati Leusë furnizohet me ujë të pijshëm nëpërmjet burimeve me vetërrjedhje i cili grumbullohet në depon e shpërndarjes me ngritje mekanike.

Lumenj, Përrenj

Në lindje të fshatit Leusë, 2 km larg tij kalon lumi Vjosë. Fshatin e përshkon një përrua që mban dhe emrin e fshatit, Përroi i Leusës, i cili rrjedh nga shpatet e Malit të Dhëmbelit, duke përshkuar fshatin dhe derdhur në lumin e Vjosës.

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Në fshatin Leusë nuk ka toka të ndara sipas ligjit nr. 7501 megjithëse aktualisht janë 15 ha tokë e pandarë dhe kjo për arsye sepse banorët e këtij fshati nuk e kanë pranuar tokën e dhënë por kanë preferuar në vend të saj asistencën ekonomike.

Besimi fetar

Në këtë fshat është e ndërtuar dhe funksionon një kishë e fund shekullit XVIII, kisha e “Shën Marisë”. Është objekt i trashëgimisë kulturore i kategorisë së I, i shpallur me vendim Nr. 6 datë 15.01.1963.



Figura 92 Kisha e "Shën Marisë" në fshatin Leusë

Ndodhet buzë fshatit Leusë. Pjesa e përparme e kishës është si manastir, kurse vetë kisha është si tempull dhe rrethohet nga 3 përrenj të mëdhenj që dalin nga malet dhe derdhen në lumin Vjosa. Përpara kishës gjenden disa monumente të vjetra varresh të viteve 1800-1900. Kisha është rikonstruktuar në vitin 2000.

Është e tipit bazilikas me përmasa 23 x 10,5 m . Kisha ka një naos të ndarë në 3 nefe, ku nefet anësore janë të mbuluara me kësulë sferike, ndërsa nefi qendror me qemer cilindrik. Kupola ngrihet mbi tamburin e ngushtë të lartë dhe në hapësirën e mesit ndohen 12 dritare. Struktura kompletohet nga një narteks dykatësh dhe altari. E gjithë ndërtesa është e ndërtuar me gurë vendi dhe e mbuluar me rrasa guri. Kisha ka edhe një mbishkrim të pikturuar mbi portën e hyrje, i cili dëshmon mjeshtërinë e atyre që e punuan. Pikturat murale janë të vitit 1812 ndërsa ikonostasi i gdhendur mban datën 1817. Vlera të veçanta artistike kanë afresket dhe ikonostasi i gdhendur në dru arre. Pamjet dhe kompozimet në dru të marra nga Bibla dhe nga natyra kanë një stil dhe mjeshtëri të lartë, i cili vihet re t jo vetëm tek “dera e bukur “ apo “proskinitar “ por në të gjithë trupin e ikonostasit.

5.2 Fshati Kosinë

Njësia Administrative Piskovë

Vendndodhja

Fshati Kosinë ndodhet në rrethin e Përmetit dhe shtrihet në një sipërfaqe rreth 276 890 m².



Figura 93 Pamje e fshatit Kosinë nga sateliti

Gjeografia

Fshati Kosinë gjendet në pjesën veriperëndimore të qytetit të Përmetit 6 km larg tij dhe 0.8 km nga rruga nacionale Përmet - Këlcyrë me gjatësi gjeografike 20°18'06.84" L dhe gjerësi gjeografike 40°16'18.59" V. Lartësia mbi nivelin e detit është 260 m .

Karakterizohet nga një reliev kodrinor - fushor. Kodrat përbëjnë 70% të relievit me lartësi që variojnë nga 340 – 460 m me drejtimin lindje - perëndim. Fusha e Kosinës që është pjesë e Luginës së Vjosës përbën 30% të relievit.

Kufinj

Fshati Kosinë kufizohet në veri me fshatin Alipostivan, në jug me fshatin Buhal, në lindje me fshatin Mokricë dhe Kutal dhe në perëndim me fshatin Rapcke dhe Piskovë.

Popullsia

Fshati Kosinë ka një popullsi prej 700 banorësh dhe numri i familjeve regjistrohet rreth 195.

Ekonomia

Ekonomia e këtij fshati mbështetet në aktivitetin e bujqësisë, blegtorisë, vreshtarisë, turizmit, tregëtisë, bletarisë etj. Potenciali konkurrues i produkteve është në prodhimin e rrushit, verës, rakisë, nënproduktet e qumështit, përpunimin e frutave, perimeve e zarzavateve si dhe prodhimet e tjera tradicionale.



Bujqësia: Bujqësia karakterizohet nga ferma shumë të vogla bujqësore, familjare të cilat mundësojnë sigurimin e të ardhurave. Fermerët e këtij fshati merren me kultivimin e pemëve frutore, vreshtarisë, bimëve të arave (grurë, misër) dhe perimet tradicionale.

Figura 94 Pamje nga fshati Kosinë

Pemëtaria: Përgjithësisht në këtë fshat kultivohen lajthi, kumbulla, rrushi, fiku, ftonj etj. Numërohen gjithësej pemë të shpërndara 1300 rrënjë, pjergulla 1550, vreshta 9.5 ha, pemë në blloqe 4.5 ha dhe ullinj 0.4 ha. Përpunimi i tyre bëhet në punishtet e përpunimit të rrushit, të reçelrave që ka njësi administrative Piskovë dhe Bashkia Përmet, si dhe në mënyrë artizanale mbi baza familjare për nevojat e veta.

Blegtoria: Është ndër burimet kryesore për të krijuar të ardhurat ekonomike të familjeve. Këtu mbarështohen të imta dhe gjedhë. Numri i tyre arrin në 332 të dhirta, 200 të leshta dhe 122 gjedhë. Nuk ka punishte të përpunimit të bulmetit si baxho. Qumështi tregëtohet në punishtet e përpunimit të Bashkisë Përmet.

Pyjet: Fshati Kosinë rrethohet nga një sipërfaqe pyjesh prej 400 ha, sipërfaqe e cila futet në Zonën e Mbrojtur. Bimësia është kryesisht mesdhetare dhe përfaqësohet nga shkurret, dushqet dhe haloret.

TREMBËDHJETË PETALET E PARA NË BUQETËN RURALE

Kullotat: Në këtë fshat ka një sipërfaqe kullosore prej 250 ha me kullota që shërbejnë për mbarrësimin e blegtorisë të cilat ndodhen në pjesën veri-lindore të fshatit.

Arsimi dhe Shëndetësia

Në këtë fshat ka një shkollë të ciklit 9-të vjeçare dhe një kopësht për fëmijë. Gjithashtu në fshat ka një dhe një qendër shëndetësore me personelin përkatës mjekësor.

Rrjeti Rrugor



Fshati Kosinë lidhet me qytetin e Përmetit nëpërmjet një rrugë automobilistike me gjatësi 6 km (rruga nacionale). Gjatësia e rrugës që lidh fshatin me rrugën nacionale është 0.8 km. Rrugët e brendshme të fshatit kanë një gjatësi prej 4 km të paasfaltuara.

Figura 95 Rrugët e fshatit Kosinë

Rrjeti Ujor

Uji i pijshëm

Fshati Kosinë furnizohet me ujë të pijshëm nëpërmjet depos së fshatit që mbushet me ngritje mekanike me kapacitet 100 m³.



Figura 96 Burimi i parë me ujë të pijshëm

Liqene

Ky fshat ka ujëmbledhësin e vet me kapacitet prej 350 000 m³. Ujërat e këtij ujëmbledhësi shërbejnë për ujitjen e bimëve nga fermerët i cili më pas shpërndahet nëpërmjet rrjetit të kanaleve ujitëse.

Lumenj, Përrenj

Territorin e fshatit Kosinë e përshkon lumi Vjosa, lumi i Lumnicës i cili është kufiri ndarës me fshatin Piskovë, Përroi i Mokricës dhe Përroi i Kosinës.

Rrjeti kullues

Fshati Kosinë në të gjithë sipërfaqen e luginës në ngastrat e tokave ka ndërtuar rrjetin e kanaleve kulluese.

Toka të ndara me Ligjin Nr.7501

Për banorët e fshatit Kosinë, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, në kuadër të reformës për tokën bujqësore për 134 familje janë shpërndarë gjithsej 340 ha tokë bujqësore.

Besimi fetar

Kisha “Shën Maria e Kosinës” në rrethin e Përmetit me histori mijëra vjeçare, është e dyta për nga vjetërsia në Ballkan. Kjo kishë, e ndërtuar në shek XII, është objekt i trashëgimisë kulturore shpallur me Vendim Nr. 6 datë 15.01.1963.

Është e stilit bizantin, vetëm me qemere dhe në anën veriperëndimore, ka disa mbishkrime të panjohura. Është e tipit kryq i brendashkruar me kupolë me tambu dhe përbëhet nga narteksi që është drejtkëndësh dhe mbulohet me qemer cilindrik me formuese veri-jug. Narteksi nga ku është hyrja për te naosi përbëhet nga mjedisi qendror me kupolë, katër krahët e kryqit dhe nga mjediset këndore. Porta e hyrjes mbulohet me hark ndërsa tamburi cilindrik është i ndërtuar me tulla ashtu si dhe muret. Ngarkesa e jashtme dekorative është shumë interesante dhe gërshetohet me një sërë motivesh, të realizuar me tulla në muraturë që formojnë simbole dhe shkronja (kryqe, harqe, korniza dhëmbësharrë, friza kurrizpeshku).

Së fundmi i është nënshtruar rikonstruksionit dhe çdo vit vizitohet nga mbi 2000 turistë.



Figura 97 Kisha e Shën Mërisë në fshatin Kosinë

5. BASHKIA KËLCYRË

6.1 Fshati Malëshovë

6.1 Fshati Malëshovë

Njësia Administrative Piskovë

Vendndodhja

Fshati Malëshovë është një ndër gjashtë krahinat e rrethit të Përmetit, që shtrihet në rrëzë të Kristoforit, në veriperëndim të Malit të Dhëmbelit dhe laget nga lumi Vjosë.

Shtrihet në të dy anët e Dhëmbelit dhe në faqen e lindjes, afër Vjosës, renditen njëri pas tjetrit fshatrat Hargovë, Grabovë, Mbrezhdan ndërsa pas malit ndodhen fshatrat Leskaj, Malëshova, Limari dhe Kalaja, gjithësej shtatë fshatra.

Sipërfaqja e përgjithshme e këtij fshati është rreth 200.000 m² e ndodhur në lartësinë 911 m mbi nivelin e detit.



Figura 98 Fshati Malëshovë i parë nga sateliti

Historia

Malëshova, kjo krahinë e fshehur malore në Shqipërinë e Jugut është ndoshta ndër më të bukurat si natyrë por fatkeqësisht, për shkak të terrenit të thyer, me pak resurse ekonomike.

Malëshovitët kanë qenë vazhdimisht aktiv dhe të angazhuar në veprimtari politike dhe atdhetare në vendet ku kanë punuar. Në vitin 1924, 206 bashkëfshatarë të krahinës së Malëshovës, kanë qenë anëtarë dhe vullnetarë të

shoqërisë “Vatra” dhe degëve të saj në Amerikë. Kontributin e tyre e vlerëson edhe Imzot Noli kur thotë “...janë këta malëshovitë dhe mbrezhdanakë që më kanë përkrahur vazhdimisht e tërësisht për të kryer detyrën e shenjtë ndaj kombit”. Është ndoshta kjo simpati e Nolit për malëshovitët, që, pas vdekjes së tij, ai që e zëvendësoi Nolin në Kishën Autoqefale të shqiptarëve të Amerikës në vitin 1967, ishte at Stefan Lasko nga Malëshova.

Krahina e Malëshovës me bukuritë që i ka falur natyra por edhe me shpirtin e ndjeshëm të njerëzve të saj është bërë burim frymëzimi për shumë krijues të kësaj treve. Vjershat e Llukan Laskos të botuar në Kalendarin Kombiar shquhen për forcën dhe frymëzimin ndaj atdheut. Po ashtu vjershat e Sejfulla Malëshovës kanë shërbyer si gurë frymëzimi për një plejadë të mëvonshme krijuese malëshovite si Lliko Nano, Niko Tyto, Rrapo Këllëçi, Dashamir Malo etj., si dhe publicistëve dhe gazetarëve të sotëm, Filip Rrumbullaku, Themistokli dhe Arben Todhe, Kastriot Korro, Bejdo Malo e shumë të tjerë.

Rrallë mund të gjesh një trevë si Malëshova, ku thonjtë e erozionit të gërryejnë aq thellë. Nga ana tjetër rrallë mund të gjesh njerëz të lidhur kaq shumë me vendlindjen e tyre, aq sa shpesh thuhet se Malëshovën e kanë mbajtur malëshovitët dhe jo Malëshova malëshovitët.

Gjeografia

Fshati Malëshovë shtrihet në gjatësinë gjeografike 20°11' 36.61" L dhe gjerësi gjeografike 40° 15'39.80" V. Karakterizohet nga një terren malor të rrethuar nga lartësitë 1053 m në veri, 1229 m, 1151 m në veri - lindje dhe mali Sheshi i Malit 1294 m në lindje.



Figura 99 Mali “Sheshi i Malit” i parë nga fshati Malëshovë

Kufijtë

Fshati Malëshovë kufizohet në veri me Këlcyrën, në jug me fshatin Leskaj, në veri-lindje me fshatin Mbrazhdan, në perëndim me fshatin Peshtan dhe në jug-perëndim me fshatin Limar e Kala.

Popullsia

Pas viteve 1990, malëshovitët kanë lëvizur në masë të madhe duke e boshatisur pothuajse gjithë krahinën. Aktualisht ka një popullsi prej 174 banorë dhe numri i familjeve është zvogëluar në 52.

Ekonomia

Ekonomia e këtij fshati mbështetet në aktivitetin e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë dhe turizmit. Potenciali konkurrues i produkteve është në prodhimin e nënprodukteve të qumështit. Prodhimet e perimeve, frutave dhe rrushit bëhen mbi bazën e ekonomisë familjare. Gjithashtu e një rëndësie të veçantë janë edhe prodhimet dhe gatimet tradicionale.

Bujqësia

Bujqësia karakterizohet nga ferma shumë të vogla bujqësore, familjare të cilat mundësojnë sigurimin e të ardhurave. Fermerët e këtij fshati merren me kultivimin e pemëve frutore, bimëve të arrave (grurë, misër) dhe perimet tradicionale.

Pemëtaria

Në këtë zonë kultivohen kryesisht rrushi në pjergulla, fiku, ftoi, manat e rakisë etj. Gjithësej numërohen rreth 130 pemë të shpërndara dhe 180 pjergulla, përpunimi i të cilave bëhet në mënyrë artizanale nga familjet e zonës.

Blegtoria

Blegtoria është ndër burimet kryesore për të krijuar të ardhurat ekonomike të familjeve. Këtu mbarështohen bagëti të imta dhe gjedhë. Numri i tyre arrin në 400 të dhirta, 590 të leshta dhe 45 gjedhe.

Pyjet

Fshati Malëshovë rrethohet nga një sipërfaqe pyjesh prej 1400 ha, pyjet e Luginës së Zagories, të shpallura zonë e mbrojtur.

Bimësia është e tipit mesdhetar. Ajo përfaqësohet kryesisht nga shkurret, dushqet dhe halorët.

Kullotat

Në këtë fshat ka një sipërfaqe kullimore prej 1800 ha me kullota që shërbejnë për mbarështimin e blegtorisë të ndodhura në pjesën jug - perëndimore të fshatit.

Arsimi dhe Shëndetësia

Në vitet e kaluara, banorët e kësaj krahine duke parë që të ardhurat ishin të pakta dhe jeta e vështirë, shpëtimin e kanë gjetur te arsimimi. Janë të shumtë kuadrot me arsim të lartë dhe intelektualët e dalë nga kjo zonë. Vetëm mësues numërohen 145 të tillë, ekonomistë 78, mjekë 37, oficerë 92, inxhinierë 70 agronomë janë 25, zooveterinerë 18, juristë 14, artistë 12, fetarë 19 etj. Aktualisht në fshat funksionon një shkollë 9- vjeçare.

Në fshatin Malëshovë funksionon një qendër shëndetësore ambulatorie me personelin përkatës mjekësor.

Rrjeti rrugor

Fshati Malëshovë lidhet me qytetin e Këlcyrës nëpërmjet një rruge automobilistike rurale e pa asfaltuar me gjatësi 17.4 km. Gjatësia e rrugës që lidh fshatin me rrugën nacionale është 15 km deri tek Gryka e Këlcyrës. Rrugët e brendshme që lidhin Malëshovën me Leskaj janë 3.1 km ndërsa me Limarin 5.4 km, të paasfaltuara.

Rrjeti ujor

Uji i pijshëm

Fshati Malëshovë furnizohet me ujë të pijshëm nëpërmjet depos së fshatit e cila ka një kapacitet 15 m³ e pajisur me rrjet ujor shpërndarës.

Lumenj (Përrenj)

Territorin e fshatit Malëshovë e përshkojnë lumi i Zagories me drejtim veriperëndim si dhe tre përrenj sezonale: Përroi i Madh, Përroi i Malëshovës dhe Përroi i Leskajt.

Toka të ndara sipas Ligjit Nr. 7501

Për banorët e fshatit Malëshovë, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “*Për tokën*”, në kuadër të reformës për tokën bujqësore për 50 familje janë shpërndarë gjithsej 101 ha tokë bujqësore.

Besimi fetar

Ajo që është më interesantja në këtë njësi të vogël gjeografike dhe etno-kulturore është se ka një përzierje të veçantë fetare. Popullsia e Malëshovës, Mbrezhdanit dhe Hargovës janë ortodoksë, Grabova dhe Limari i ka prezent të dy besimet (ortodoksë dhe bektashi) ndërsa fshati Leskaj është fshat me besimin bektashi.

Aktualisht në fshat është në funksion kisha e Shën Kristoforit dhe gjithashtu gjenden edhe gjashtë kisha të tjera të rrënuara, dy xhami janë jashtë funksionit dhe për popullatën e besimit bektashi egziston një teqe në fshatin Leskaj.



Figura 100 Kisha e Shën Kristoforit

Kultura dhe Turizmi

Në këtë fshat ushtron veprimtarinë artistike grupi folklorik “Gura e Prodanit” i cili ka realizuar dy albume me këngë dhe valle popullore të krahinës.

Natyra e veçantë e kësaj treve paraqet vitet e fundit një interes të madh për turizmin malor. Ndër objektet që evidentohen në këtë zonë janë:

- Kalaja e Limarit, objekt i trashëgimisë kulturore, kategoria I
- Ura e Kalasë, mbi Lumin e Zagories, objekt i trashëgimisë kulturore, kategoria I
- Guri i Menhirit (objekt natyror), shtëpitë karakteristike ndërtuar me gurë
- Lugina e Zagories

7. BASHKIA DROPULL

7.1 Fshati Sotirë

7.1 Fshati Sotirë

Njësia Administrative Dropull i Sipërm

Vendndodhja

Fshati i Sotirës ndodhet në jug-perëndim të bashkisë së Dropullit midis grykave mahnitëse të Coklit të Selos, grykës së Havos në Sotirë dhe grykës së Koshovicës, në bashkinë Dropull të qarkut Gjirokastrë. Sotira një prej zonave më piktoreske të Dropullit të Sipërm në kufi me Greqinë, përfaqëson një prej parqeve më të bukur natyrore në zonën e Gjirokastrës.



Figura 101 Pamje e fshatit Sotirë nga sateliti

Fshati Sotirë ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 623 479 m², në të cilën përfshihen vija e verdhë e fshatit, tokë e pafrytshme dhe tokë bujqësore. Kjo sipërfaqe shtrihet në kuotat 500 – 600 metra mbi nivelin e detit.

Gjeografia

Fshati Sotirë shtrihet në pjesën jugore të bashkisë Dropull, qarku i Gjirokastrës në kufi me Greqinë. Terreni në të cilin shtrihet fshati i Sotirës është kryesisht malor dhe i pyllëzuar. Lartësia e relievit të këtij fshati, përfshirë edhe monumentin e natyrës Bredhi i Sotirës, shtrihet nga kuota 500 metra mbi nivelin e detit e deri në kuotë 1750 m.

Kufijtë

Fshati i Sotirës kufizohet:

- Nga veriu me fshatin Krioner, mali i Selosë, njësi administrative Dropull i Sipërm
- Nga jugu me kufirin me shtetin e Greqisë, mali i Stugarës
- Nga lindja me fshatin Llongo, njësi administrative Dropull i Sipërm
- Nga perëndimi me kufirin me shtetin e Greqisë, mali i Stugarës

Popullsia

Ndër vite popullsia lokale ka ndryshuar strukturën e saj për shkak të problematikave dhe izolimit të zonës. Aktualisht kjo zonë ka një popullsi prej rreth 390 banorësh. Ky numër ndryshon gjatë vitit, ndërsa në periudhën e verës, kur pjesa më e madhe e popullsisë kthehet nga emigrimi, ky fshat rifiton gjallërinë e tij.

Në këtë zonë ka 145 ndërtesa të vjetra të karakterit individual me maksimumi 2 kate, të ndërtuara me gurë, por pak të mirëmbajtura, për shkak dhe të mundësive ekonomike të limituara të banorëve dhe vështirësisë në akses.

Fshati Sotirë deri në vitet 90 ka patur rreth 200 shtëpi të banuara, ndërsa sot shumica e tyre janë të braktisura, pasi banorët e tij kanë emigruar kryesisht në Greqi apo në vende të tjera. Aktualisht në fshat jetojnë jo më shumë se 40 banorë, kryesisht moshë e tretë.

Ekonomia

Duke qënë se shumica e banorëve të fshatit, në pjesën më të madhe të vitit jetojnë në emigracion, ekonomia e banorëve aktualë të fshatit mbështetet kryesisht në prodhimet e kopshteve personale dhe të turizmit sezonal e spontan.

Në zbatim të programit zhvillimor, banorë e fshatit Sotirë përmirësimin e jetës e shikojnë në ofrimin e shërbimeve për turistët, kthimin tek përvoja e përpunimit të esencave të halave të bredhit, pishës e sherebelës, tek investimet që mund të realizohen në turizëm, artizanat, bujqësi e gjetkë, hartimin e zbatimit të një plani menaxhimi nga struktura të specializuara si mbështetje për punësim dhe sigurim të ardhurash.

Sotira dikur e njohur për punishten që përpunonte esencat e bredhit, sherebelës, pishës, sot aktiviteti kryesor për këtë zonë është mbledhja e bimëve medicinale, bimëve aromatike (rigoni i bardhë) dhe çajrave të ndryshëm. Edhe pse ky aktivitet zhvillohet në mënyrë individuale të pa-organizuar, aksesin në treg është

mjaft i vështirë dhe kushtëzon zhvillimin e mëtejshëm të këtij aktiviteti. Kjo për shkak edhe të mungesës së një pike grumbullimi dhe përpunimi, apo dhe mungesës së identitetit të produkteve lokale përmes brandimit dhe markës lokale në treg.

Për shkak të pozitës gjeografike, cilësive mjaft të mira peisazhiste dhe afërsisë me zonën e mbrojtur, ky fshat në mënyrë spontane ka zhvilluar një turizëm malor, peisazhistik dhe eko-turizmin.

Momentalisht zona nuk zotëron kapacitetet e nevojshme (për strehim dhe ofrim shërbimesh) për të mirëpritur turizmin në mënyrë të organizuar, por kjo s'ka penguar ardhjen e turistëve. Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit ekonomik në zonë e përbëjnë blegtoria dhe produktet blegtorale. Ky sektor gjithsesi has të njëjtën problematikë në lidhje me aksesin dhe brandimin (marketimin), duke ulur ndjeshëm interesin e popullsisë lokale për të qëndruar dhe operuar në zonë përtej sezonit të verës dhe të aktiviteteve kulturore.

Bujqësia

Kryesisht ata banorë të këtij fshati që jetojnë gjatë gjithë vitit, shfrytëzojnë kopshtet personale për prodhime bujqësore. Kjo zonë shquhet për kultivimin e patates dhe të fasules pllaqi.

Pemëtaria

Në territorin e fshatit Sotirë ekziston pylli i gështenjës, ndërsa nëpër kopshtet pranë banesave predominon pema e arrës.

Aktualisht në këtë fshat nuk ka punishte për përpunimin e frutave, as për raki dhe as për prodhimin e verës. Çdo familje përpunon dhe prodhon në mënyrë private dhe artizanale verën dhe rakinë për konsumim familjar.

Kjo zonë ndodhet e rrethuar nga natyra dhe peisazhi malor. Bimët medicinale dhe ato aromatike përbëjnë një pjesë të mirë të produkteve lokale që prodhon zona, të cilat mund të kthehen në produkte promovuese edhe të agro-turizmit. Disa nga produktet janë: çajrat terapeutike, çaji i sherebelës, rigoni i bardhë, mentja e egër, njëmijëfletëshi, trumza, zhumbriça, trëndafil i egër, aguliçe, dëllenjë e zezë, shtog, hithër, lulëkuqe dhe kamomil. Produkte të tjera që mund t'i shtohen gamës së ofruar në kuadër të zhvillimit të agro-turizmit janë: trofta, derri i egër, kërpudhat e egra, frutat e pyllit dhe shumë produkte të tjera bio.

Blegtoria

Në këtë fshat nuk ka baxho për përpunimin e produkteve të qumështit. Sipas statistikave të njësive vendore, ka kryesisht bagëti të imta të cilat kapin shifrën rreth 80 – 100 krerë.

Kullota

Në zonën e fshatit Sotirë ka gjithësej 346.5 ha kullota, nga të cilat 47 ha kullota verore dhe 299.5 ha kullota dimërore.

Arsimi dhe Shëndetësia

Aktualisht në këtë fshat nuk ka shkollë aktive dhe funksionale, kjo pasi për efekt të emigracionit, nuk ka fëmijë të moshës për t'u arsimuar.

Në qendër të fshatit, midis objekteve të shërbimit, dallohet *Shkolla me Sahat* e fshatit me vlera historike.



Figura 102 Shkolla me Sahat në fshatin Sotirë

Kjo shkollë karakteristike ndodhet pranë sheshit qendror, një ndërtesë dy katëshe me vlera arkitektonike, e cila nëse riaktivizohet mund të mbulojë mjaft mirë nevojat e zonës për arsimim dhe të shërbejë edhe si qendër sociale.

Në këtë fshat ka një infermieri ku kryhet shërbimi parësor për banorët e fshatit nëpërmjet specialistit infermier.

Rrjeti rrugor

Ky fshat ka vetëm një rrugë automobilistike. Kjo rrugë që fillon nga qendra e Llongos (poshtë) e deri në qendër të fshatit Sotirë ka një gjatësi prej 3.8 km, është mjaft e amortizuar dhe e ngushtë me vetëm një kalim dhe pa xhepa emergjence për shkëmbimin e automjeteve. Përgjatë shtrirjes së rrugës ka burime të shumta ujore, të cilat kalojnë torthorazi duke e bërë shumë të vështirë kalimin në stinën e dimrit, kur këto burime ngrijnë.

Mungesa e një sistemi largimi të ujërave nga rruga është një domosdodhmeri për të shmangur izolimin e zonës. Kjo rrugë lidh fshatin e Sotirës me Krionerin, Llongon, Koshovicën dhe së fundmi me rrugën kryesore përgjatë lumit Ajorji

me fshatin Vrisera si qendër njësie administrative. Fshati Sotirë lidhet gjithashtu nga ana perëndimore dhe jugore me rrugë malore e shtigje me fshatin Selo dhe Koshovicë. Riaktivizimi i këtyre shtigjeve dhe kalimeve do të favorizojë me tej zhvillimin e turizmit malor, alpinizmit apo edhe ski (maja e Murganës 1846 m) në këtë zonë.

Rrjeti Ujor

Uji i pijshëm

Uji i pijshëm për banorët e këtij fshati, veçanërisht për banesat e sipërme të fshatit, realizohet me ngritje mekanike (sistem pompimi) ku furnizohen dy depo uji dhe me rrjetin e brendshëm shpërndarës për banesat.

Në qendër të fshatit ka çesmë me ujë të rrjedhshëm 24 orë me prurje 0.5 – 1 litër/sekondë.

Liqene

Brenda territorit në juridiksionin e këtij fshati nuk ka të ndërtuar ndonjë ujëmbledhës apo liqene natyralë për ujitjen e tokave bujqësore. Ato pak parcela që mund të shfrytëzohen, ujiten me ujë të rrjedhshëm me rrjedhje të lirë nga lumi.

Lumenj –Përrenj

Një element, i cili i shton vlerat peizazhistike zonës, është dhe pasuria e rrjetit hidrografik me rrjedha të shumta sezonale dhe përrenj si ai i Sotirës që kalon në këtë vendbanim dhe furnizon me ujë lumenjtë e Kserias dhe Llongos që ky i fundit kalon në territorin e fshatit Sotirë.

Pyjet (Zona të mbrojtura)

Zona e Mbrojtur Monument Natyre “Bredhi i Sotirës” është bërë pjesë e zonave të mbrojtura si zonë e kategorisë së III me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 102, datë 15.01.1996, Bredhi i Sotirës me një sipërfaqje prej 1740 ha, nga të cilat vetëm 1 586.75 ha ndodhen brenda territorit të bashkisë Dropull, me gati 75% pyje dhe pjesa tjetër kryesisht kullota dhe sipërfaqe shkëmbore. Monumenti i natyrës Bredhi i Sotirës është një peisazh unikal midis grykave mahnitëse të Coklit në Selo, gryka e Havos në Sotirë e deri tek gryka e Koshovicës dhe ndodhet në pjesën Jugore të Shqipërisë, në kufi me Greqinë. Gjithashtu ndodhet në skajin jugor të bashkisë së Dropullit, mbi Malin e Stugarës.

Kjo zonë kufizohet në veri me Majën e Amblikos me lartësi 1333 m dhe ndjek kurrizin në drejtim të kuotës 653 m deri në Përroin e Selosë. Në lindje ndjek rrugën automobilistike në kufirin shtetëror me Greqinë, maja e Musovunit dhe

maja e Murganës. Bredhi i Sotirës ndodhet 0.4 km nga Sotira në vijë ajrore, 0.3 km nga fshati Selo në vijë ajrore dhe 3.7 km në vijë ajrore nga rruga kryesore, duke e bërë këtë zonë një vend të qetë dhe me vlera të larta biodiversiteti nga pikëpamja e habitateve dhe llojeve, me vlera të konsiderueshme shkencore dhe



Figura 103 Bredhi i Sotirës

eko-turistike. Në zonën e mbrojtur të Bredhit të Sotirës, sipas hartave të përbërjes gjeologo-inxhinjerie të tokave evidentohen ndarje të tre klasifikimeve kryesore bazuar në gjenezën e shkëmbinjve, veçorive petrografike dhe gjeomorfologjike shkëmbinj të fortë gëlqerorë dolomitike dhe evaporite.

Biodiversiteti i Bredhit të Sotirës përfaqëson një natyrë të virgjër, komplekse dhe të pasur me vlera si nga ana ekoturistike dhe nga ajo shkencore. Hapësira në të cilën ndodhet dhe pozicionimi i tij largë rrugës dhe vendbanimeve, e bëjnë të pasur në aspektin e biodiversitetit të habitateve dhe llojeve të vegjetacionit, ku një pjesë dominante zihet nga Flora e Dushkajave të përherë-blerta, e cila karakterizohet nga pyjet: qarr, mëllëzë, shkozë, frashër, rrapishtet, (*Crataegus monogyna*) bimë mjekësore me veti të larta dhe përdorime të ndryshme industriale dhe vetiake, (*Rubus ulmifolius*) një lloj manaferrash të egra, (*Sanguisorba minor*) e cila është një bimë në familjen e (*Rosaceae*) ose trëndafilave, që përbën një nga 4828 speciet e njohura dhe rritet në pjesët shkëmbore të parkut. Kjo bimësi gjen përdorim gjithashtu në mjekësi në formën e çajit. Shoqërim interesant dhe dominant mbetet edhe *Abies borisii-regis* (*Huetio-Abietum*), ndryshe Bredhi i Bardhë me prejardhje ballkanike. Kati shkurror përbëhet kryesisht nga murrizi (*Crataegus heldreichii*), dëllinja e zezë (*Juniperus communis*), (*Daphne mezereum*) etj.

E përbërë nga male, kodra dhe një luginë ku ndodhet dhe fshati i Sotirës, kjo zonë është e pasur me pyje të dendur si pisha e zezë, bredhi i bardhë, ahu, panja e malit, shelgu i egër, bunga, bimë mjekësore, lule të rralla etj.

Zona ka një faunë të egër që përfshin: derrin e egër, lepurin e egër, ujkun, kaprollin, dhelprën, thëllëzën e malit etj.

Në këtë zonë para vitit 1990 bëhej përpunimi i drurit dhe nxjerrja e rrëshirës. Ka patur gjithashtu dhe punishte që përpunonte esencat e halave të bredhit, pishës dhe sherebelës.

Toka të ndara me Ligjin Nr. 7501

Për banorët e fshatit Sotirë, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, në kuadër të reformës për tokën bujqësore për 104 familje me 333 banorë janë shpërndarë gjithsej 22 ha tokë bujqësore.

Besimi fetar

Në qendër të fshatit, midis objekteve të shërbimit, dallohet Kisha Ortodokse e Shën Sotirit, monument me vlerë të çmuar. Kjo kishë njihet me emrin Kisha e Metamorfosis Sotira që do të thotë përafërsisht “*ndryshim shpëtimtar*”.

Ndërsa në të dalë të fshatit, në vendin ku dikur, kur druvarët e fshatit largoheshin duke braktisur fshatin dëgjuan zëra, kanë ndërtuar kishën e Shën Thanasit.



Kultura dhe Turizmi

Në këtë fshat aktualisht është e ndërtuar një vatër kulture. Banorët e këtij fshati kanë vallet tradicionale të krahinës dhe nëpër festa, gosti e aktivitete të tjera (dasma) këndojnë veçanërisht këngë polifonike të zonës.

Figura 104 Kisha e Shën Thanasit

Në zonën e Dropullit të Sipërm, çdo fshat ka një festë përgjatë muajit gusht, festë që zgjat zakonisht dy apo tre ditë. Këto festa ofrojnë një mundësi takimi të banorëve të cilët mund të jenë shpërngulur nga fshatrat prej dekadash, por që



Figura 105 Tradita kulturore e Sotirës

gjejnë mundësinë për t'u kthyer e për t'u takuar me njëri tjetrin. Data 6 Gusht është dita e festës së *Metamorfosis Sotira*, festë me karakter fetar, që festohet çdo vit në fshatin Sotirë, prandaj ky fshat ka një rol të rëndësishëm për bashkinë e Dropullit pasi aty zhvillohet dhe kjo festë historike e Metamorfosis (transformimi i shpëtimtarëve).

Çdo vit ky fshat pret më shumë se 700 vizitues për këtë festë, e cila ndodh përreth Kishës së Shën Thanasit ku dikur qëndronte Manastiri i vjetër dhe Kishës së Metamorphosis, ku më të rinjtë kërcëjnë dhe përcjellin traditën, duke treguar historinë e krijimit të fshatit dhe legjendat e ngritura mbi këtë fshat.

Vende Turistike

Monument Natyre “Bredhi i Sotirës”: Është bërë pjesë e zonave të mbrojtura si zonë e kategorisë së III me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 102, datë 15.01.1996.

Bredhi i Sotirës ka një sipërfaqje prej 1,740.00 ha, nga të cilat vetëm 1,586.75 ha ndodhen brenda territorit të Bashkisë Dropull, me gati 75% pyje dhe pjesa tjetër kryesisht kullota dhe sipërfaqje shkëmbore. Ky monument natyre është një peisazh unik midis grykave mahnitëse të Coklit në Selo, gryka e Havos në Sotirë e deri tek gryka e Koshovicës.

Një element, i cili i shton vlerat peizazhit të zonës është dhe pasuria e rrjetit hidrografik me rrjedha të shumta sezonale dhe përrrenj si ai i Selosë që kalon në vendbanimin e Selosë dhe furnizon lumenjtë e Kserias dhe Llongos që ky i fundit kalon në vendbanimin e Sotirës.

Shpatet e maleve, rrjeti i përrrenjve me shumë shtigje ofrojnë mundësi për ekoturizëm dhe alpinizëm.

Rrapi shumë vjeçar: Është një atraksion që i jep një vlerë të shtuar qendrës së fshatit ku nën hijen e saj afrohen edhe shumë turistë vendas e të huaj.



Figura 106 Rrapi i vjetër në fshatin Sotirë

Disa nga elementët me vlerë kulturore për t'u promovuar më gjerë janë Shkolla 8-vjeçare e Sotirës, Kisha e Shën Sotirës, rikthimi i Mullirit me ujë që është dhe një veçori e zonës, Sharra me ujë etj.



© Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë
Gjirokastrë 2018

Sheshi " Çerçiz Topulli", Gjirokastrë/Shqipëri

Tel: ++355 84 26 3435

Fax: ++ 355 84 26 3434

E-mail: Prefekti.Gjirokastrë@mb.gov.al

Redaktimi: Arjeta Paçeli, Edlira Shehu

Projektimi grafik: Edlira Shehu

Kopertina: Enea Mijo

Realizimi grafik: GrandIdea



DHOKSAT



MALESHOVË



ZHULAT



ANTIGONE



LAZARAT



LABOVË E SIPËRME



NEPRAVISHTË



DHOKSAT



MALESHOVË



NIVICË



PESHATAN



KALIVAC



LEUSË



KOSINË



SOTIRË